



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.2;22X-2009/17-08

**RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
EFEKTIVITETI I SISTEMIT INFORMATIV TË TATIMIT NË PRONË**

Prishtinë, prill 2018

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime të pavarura, objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë¹, efikasitetit² dhe efektivitetit³ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me këtë raport të auditimit “Efektiviteti i sistemit informativ të tatimit në pronë” në konsultim me ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Vlora Spanca, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e ka realizuar këtë raport:

Myrvete Gashi, drejtore e auditimit

Saranda Husaj Baraliu - udhëheqëse e ekipit

Elvin Mala dhe Shqipe Mujku Hajrizi – auditor të TI-së; anëtar ekipi

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT –Adresa: Musine Kokalari, Nr. 87, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel.: +383 (0) 38 60 60 04/1002/1012-FAX: +383 (0) 38 2535 122 /219
<http://zka-rks.org/>

¹ Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë

² Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës.

³ Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	iii
1 Hyrje.....	1
1.1 Problemi i auditimit.....	3
1.2 Objektiva e auditimit.....	4
1.3 Pyetjet e auditimit.....	5
1.4 Kriteret e auditimit.....	5
1.5 Fushëveprimi i auditimit.....	6
1.6 Metodologjia e auditimit.....	7
2 Përshkrimi i procesit, palët përgjegjëse dhe trupat mbështetës për zbatimin e SITP-së	9
3 Gjetjet e auditimit.....	11
3.1 Qeverisja e TI-së dhe roli i saj në zhvillimin, funksionimin dhe operimin e SITP-së.....	11
3.1.1 Strategjia e Teknologjisë Informative.....	11
3.1.2 Struktura organizative, politikat dhe procedurat për zhvillimin e SITP-së.....	12
3.1.3 Shtrirja e sistemit.....	12
3.1.4 Zhvillimi i projektit, strukturat udhëheqëse dhe mbikëqyrja e projektit.....	13
3.1.5 Identifikimi i kërkesave për ndryshime.....	14
3.2 Efektiviteti i kontrolleve të aplikacionit.....	15
3.2.1 Të dhënat hyrëse.....	16
3.2.2 Plotësia dhe saktësia e të dhënave në dalje.....	19
3.2.3 Siguria e aplikacionit.....	25
3.3 Efektiviteti i menaxhimit të shërbimeve.....	27
3.3.1 Kërkesat e përdoruesve të sistemit.....	27
3.3.2 Matja e performancës së sistemit, vendosja e kufijve kritik për matje dhe krahasim të rezultateve.....	28
3.3.3 Mekanizmat për menaxhimin e ndryshimit.....	28
3.3.4 Ruajtja e të dhënave në kopje rezervë.....	28
4 Konkluzionet.....	29
5 Rekomandimet.....	34
Terminologjia.....	38
Shtojca 1: Të hyrat vetanake të komunave dhe pjesëmarrja në përqindje e tatimit në pronë për vitet 2014-2016.....	41
Shtojca 2: Të hyrat nga tatimi në prone për vitin 2016 për komunat sipas përqindjes së pjesëmarrjes.....	42

Lista e shkurtesave

AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
AST	Agjencia Suedeze e Tatimeve
BDA	Bordi drejtues i ankesave
DMSTI	Departamenti për menaxhimin e sistemeve të teknologjisë informative
DTP	Departamenti i tatimit në pronë
EP	Ekipi i Projektit
GMP	Grupi Menaxhues i Projektit
KD	Komiteti drejtues
LTPP	Ligji Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme
MF	Ministria e Financave
MP	Menaxher i projektit
SI	Sistemi Informativ
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
SITP	Sistemi informativ i tatimit në pronë
TI	Teknologjia Informative
TN	Tavolina Ndihmëse
TP	Tatimi në pronë
UA	Udhëzim Administrativ
UNIREF	Standard i unifikuar për numrat referent
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZKTP	Zyrat komunale të tatimit në pronë

Përmbledhje e përgjithshme

Të hyrat nga tatimi në pronë janë të hyrat kryesore vetanake të komunave, prandaj mbledhja e tyre është thelbësore në qëndrueshmërinë financiare të tyre. Pagesa e tatimit në pronë nga ana e qytetarëve, mund të konceptohet si investim në mirëqenien e tyre, ku shumica prej këtyre të hyrave rikthehen në investime kapitale për segmentet më vitale të jetës si: infrastruktura rrugore, ndërtimi i shkollave, rrjeti i ujësjellësit e kanalizimit, rrjeti i ndriçimit publik, përmirësimin e shërbimeve publike komunale, etj.

Prandaj për vjeljen sa më efektive të tatimit në pronë, është thelbësore që shkëmbimi i informatave, përditësimi i të dhënave, dhe qasja në to të funksionojë përmes një sistemi informativ të tatimit në pronë të mirë organizuar, i cili do të duhet t'i ndërlihdh dhe t'iu siguroj qasje të gjitha palëve dhe institucioneve pjesëmarrëse në këtë proces.

Sistemi informativ i tatimit në pronë është centralizuar që nga viti 2009, me anë të një projekti të përbashkët mes Ministrisë së Financave dhe Agjencisë Suedeze të Tatimeve dhe financim të Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar⁴. Sistemi është i vendosur në Ministrinë e Financave dhe shfrytëzohet nga 34 komunat e Republikës së Kosovës. Sistemi informativ i tatimit në pronë krahas përmirësimit në ofrimin e shërbimeve, ka sjellë edhe rreziqe të ndryshme lidhur me informatat të cilat i përpunon. Mangësi të këtij sistemi janë identifikuar edhe nga raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit në vitet e kaluara.

Objektiva e këtij auditimi është të vlerësohet nëse ekziston një mjedis efektiv i kontrollit në mes të strukturave udhëheqëse dhe proceseve institucionale që sigurojnë se sistemi informativ i tatimit në pronë, mbështet qëllimet dhe strategjinë e institucionit, duke ofruar informacione të besueshme, të tërësishme dhe në kohë.

Synimi i këtij auditimi është që të ofrojmë rekomandime relevante për nivelin qendror dhe palët e tjera përgjegjës në mënyrë që të përmirësohet qasja e tyre në raport me zbatimin dhe mbarëvajtjen e këtij sistemi, si dhe ofrimin e informatave të besueshme, të tërësishme dhe në kohën e duhur.

Subjekt kryesor i këtij auditimi është Ministria e Financave, përkatësisht, Departamenti i tatimit në pronë i cili është përgjegjës për zbatimin, operimin dhe krijimin e resurseve të nevojshme për mbarëvajtjen e sistemit informativ të tatimit në pronë, si dhe Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative përgjegjës për hartimin e politikave, procedurave, projekteve dhe strategjive për funksionimin normal dhe sa më cilësor të TI-së. Ndërsa, për të evidentuar gjendjen e zbatimit të projektit janë përzgjedhur katër komuna si shfrytëzuese/përdorues të sistemit: Komuna e Prishtinës, Graçanicës, Pejës, si dhe Gjakovës.

⁴ Marrëveshja në mes të palëve është lidhur në vitin 2008, ndërsa sipas planit projekti ka filluar në vitin 2009.

Konkluzion i përgjithshëm

Sistemi informativ i tatimit në pronë nuk ka arritur të jetë plotësisht efektiv.

Pavarësisht kompleksitetit të sistemit, mangësive të trashëguara nga versionet dhe të dhënat e mëhershme, si dhe kufizimeve të ndryshme në sigurimin e kapaciteteve, sistemi ka një bazë të mirë si dhe informata të bollshme. Po ashtu, duhet theksuar kontributin e dhënë nga projekti për përkrahjen e këtij sistemi duke ndikuar në rritjen e të hyrave nga tatimi në pronë nga viti 2010 në 2016 në 86%. Edhe pse projekti është paraparë të përfundoj në dhjetor të vitit 2017, Ministria e Financave ende nuk ka arritur të përmbush kushtet e marrëveshjes, duke rrezikuar ndërprerjen e saj. Gjithashtu ende nuk ka filluar bartja e tërësishme e përgjegjësive tek Ministria e Financave ashtu siç është paraparë në fazën e tranzicionit të projektit duke e vënë në pikëpyetje funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit. Për më shumë, përkundër përpjekjeve nga Ministria e Financave, sistemi i tatimit në pronë dhe mbledhja e të hyrave nga tatimi ende nuk bëhet në të gjithë territorin e vendit. Katër komuna ende nuk janë përfshirë në sistem dhe nuk mbledhin të hyrat nga tatimi në pronë.

Po ashtu, edhe komiteti drejtues i cili e ka rolin e organit mbikëqyrës të projektit është takuar rrallë dhe nuk i ka adresuar me kohë dhe si duhet çështjet e dala gjatë zbatimit të projektit, si rrjedhojë e kësaj, zbatimi i projektit është përcjellë me pengesa të cilat kanë ndikuar në mbarëvajtjen e mirëfilltë të sistemit. Qeverisja e sistemit nuk ka rezultuar të jetë efektive. Ministria e Financave ka dështuar në hartimin e strategjisë, politikave dhe procedurave të TI-së, duke rrezikuar adresimin e burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së SITP-së.

Për më shumë, Ministria e Financave nuk ka krijuar kontrolle efektive të sistemit. Sistemi nuk posedon mekanizmat apo mjetet e duhura për të identifikuar apo trajtuar vendosjen e të dhënave jo të vlefshme. Kontrollat e plotësisë dhe saktësisë nuk janë efektive. Gjithashtu, mungon gjurmueshmëria e plotë. Të gjitha këto mangësi mund të ndikojnë në funksionimin e sistemit.

Mbarëvajtja e sistemit nuk është duke u realizuar sipas praktikave të mira. DTP nuk ka arritur të ofroj përkrahjen e duhur për shfrytëzuesit. Nuk është bërë matja efektive e sistemit, kjo pamundëson planifikimin e kapaciteteve të nevojshme për operimin e duhur në të ardhmen.

Përmirësimi i mangësive të identifikuara, dukshëm mund të ndihmoj në qëndrueshmërinë e sistemit.

Rekomandimet kryesore

Për vazhdimin e operimit të Sistemit Informativ të Tatimit në Pronë, Ministria e Financave duhet të rrisë përpjekjet për plotësimin e kushteve të marrëveshjes në mes të saj me Agjencinë Suedeze të Tatimeve dhe Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Komiteti drejtues duhet të jetë më shumë i përfshirë në adresimin e çështjeve të dala nga projekti. Ministria e Financave, përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë duhet të forcoj kontrollet e sistemit. Fillimisht, duhet hartuar procedura e më pas duhet monitoruar zbatimi i tyre në mënyrë

që të ofroj informacione të besueshme, të tërësishme dhe në kohë. Gjithashtu, nevojiten të ndërmerren hapa për përmirësimin e shërbimeve. Ndërsa, Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative duhet të shtojë përpjekjet për hartimin e strategjisë së teknologjisë informative, politikave dhe procedurave, si dhe të ndërmarrë veprime konkrete për mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit. Kjo duhet të përfshij edhe zhvillimin e strategjisë për përfshirjen e katër komunave për mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë si dhe shfrytëzimin e sistemit për menaxhimin e të dhënave të tatimit në pronë

Komunat, përkatësisht departamentet e teknologjisë informative në komuna, të bëjnë kontrollin e autorizimit të të drejtave të qasjes në kompjuter dhe të jepen privilegjet sipas detyrës. Gjithashtu, zyrtarët komunal shfrytëzues të sistemit, duhet të rrisin bashkëpunimin me Departamentin e Tatimit në Pronë, për të siguruar që kërkesat për përmirësim të sistemit janë duke u adresuar.

(Për konkluzione dhe rekomandime më të detajuara duhet referuar raportit në brendësi).

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim

Ministria e Financave përkatësisht departamenti i tatimit në pronë dhe departamenti për menaxhimin e sistemeve të teknologjisë informative si dhe komunat: Prishtinë, Pejë, Gjakovë dhe Graçanicë janë pajtuar me të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit. Inkurajojmë institucionet e përfshira në këtë auditim që t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Qytetarët e Kosovës, krahas të drejtave dhe përfitimeve të garantuara me Kushtetutën e vendit, bartin edhe obligime dhe përgjegjësi individuale ndaj institucioneve të vendit. Ndër këto obligime janë edhe tatimet, të cilat janë detyrime financiare që paguhen nga qytetarët ku në këmbim ju kthehen në të mira dhe shërbime. Andaj, pagesa e tyre nuk duhet të shihet vetëm si obligim, pasi që mjetet e vjela nga tatimi, mund të konceptohen edhe si investim i qytetareve në mirëqenien e tyre, ku shumica prej këtyre të hyrave rikthehen apo destinohen në investime kapitale për segmentet më vitale të jetës si: infrastruktura rrugore, ndërtimi i shkollave, rrjeti i ujësjellësit e kanalizimit, rrjeti i ndriçimit publik, përmirësimin e shërbimeve publike komunale, etj.

Të hyrat nga tatimet dhe taksat përbëjnë shtyllën kryesore prej së cilës varet qëndrueshmëria financiare e vendit. Tatimi në pronë⁵ është e hyrë kryesore komunale që do të thotë se të gjitha të hyrat shkojnë në buxhetin komunal dhe si e tillë përbënë rreth 30% të hyrave vetanake komunale⁶. Deri më tani, tatimi në pronë është aplikuar vetëm për objekte, ndërsa, sipas Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë⁷, është paraparë që të fillohet edhe me tatimin në tokë, si inkurajim i qytetarëve për shfrytëzimin më produktiv të tokës. Aplikimi i tatimit në tokë planifikohet të fillojë nga viti 2019⁸.

Meqenëse, tatimi në pronë është i destinuar të jetë elementi kryesor i të hyrave vetanake komunale, përmirësimi i administrimit të tij është thelbësor për qëndrueshmërinë fiskale komunale. Për vjeljen sa më efektive të tatimit në pronë, është thelbësore që shkëmbimi i informatave, përditësimi i të dhënave, dhe qasja në to të funksionojë përmes një Sistemi Informativ⁹ të Tatimit në Pronë (në tekstin e mëtejme SITP), të mirë organizuar, i cili do të duhet t'i ndërlihdh dhe t'iu siguroj qasje të gjitha palëve dhe institucioneve pjesëmarrëse në këtë proces.

SITP aktualisht i aplikueshëm në Kosovë, ka për qëllim përpunimin, llogaritjen dhe ruajtjen e të dhënave. Po ashtu, ky sistem iu ofron qytetarëve marrjen e informatave për obligimet e tyre për tatimin në pronë, pavarësisht nga cila komunë kërkohet shërbimi, si dhe duke mundësuar qasje në formë elektronike përmes e-faturës në bazë të cilës mund të bëhet edhe pagesa e këtij tatimi.

SITP ka filluar të aplikohet që nga viti 2003 kur është bërë regjistrimi i parë gjithëpërfshirës i pronave ku secila komunë ka përdorur bazën e vet të të dhënave¹⁰. Këto të dhëna janë përpunuar duke shfrytëzuar Programin MS Access¹¹. Në çdo fund vit, zyrtarët e MF-së (në tekstin e mëtejme

⁵ Tatimi në prone aplikohet për të gjitha pronat e paluajtshme mbi apo nën sipërfaqen tokësore; ligji nr.03/L-204 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

⁶ Në shtojcë 1 janë paraqitur të hyrat vetanake të komunave për vitet 2014-2016.

⁷ Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë, Republika e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Dhjetor 2016

⁸ Ligji i ri për tatimin në prone; ligji nr. 06/L-005 Për Tatimin në Pronën e paluajtshme është miratuar me 26. 01.2018, është shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës me 12.02.2018 dhe hyn në fuqi me 01 Tetor 2018.

⁹ Sistemi informativ është sistem i punës të cilin e përdorin pothuajse të gjitha organizatat për shkëmbimin dhe përpunimin e informacioneve brenda për brenda institucioneve por edhe për koordinim koherent në mes tyre. Kështu ato sigurojnë mbështetje për operacionet e veta, për të plotësuar misionin dhe objektivat e tyre.

¹⁰ Në Kosovë, legjislacioni i parë i Tatimit në pronë ishte miratuar më 2003 me anë të rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/29 "për Tatimin mbi Pronën e paluajtshme në Kosovë".


¹¹ MS Access- është sistem i menaxhimit të bazës së të dhënave, nga Microsoft.

Ministria e Financave), është dashur të marrin kopjen e të dhënave nga baza e të dhënave e secilës komunë dhe ta importojnë atë në bazën e të dhënave të tyre për përpunim të mëtutjeshëm. Sistemi si i tillë ka qenë i decentralizuar dhe MF nuk ka pasur qasje në monitorimin apo verifikimin e të dhënave të vendosura në bazën e të dhënave të sistemeve komunale deri në kohën kur është bërë importimi i tyre.

Në vitin 2008, MF në bashkëpunim me Agjencinë Suedeze të Tatimeve (në tekstin e mëtejshëm AST) dhe financim të Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (në tekstin e mëtejshëm SIDA), ka hartuar projektin Pro Tax me qëllim të regjistrimit të plotë dhe të drejtë të tatimit në pronë në mënyrë që të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit të administratës dhe të rris të hyrat në nivelin komunal. Me anë të këtij projekti ka filluar centralizimi i SITP-së. Ky projekt ka zgjatur deri në vitin 2012. Nga viti 2012 deri në vitin 2014, MF ka mirëmbajtur vet zhvillimin e sistemit me ekspertët që kanë mbetur nga projekti. Në këtë kohë projekti është përkrah me ekspertë edhe nga USAID.

Në vitin 2014, MF dhe SIDA kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi duke vazhduar me projektin e përditësuar ProTax 2, me funksionalitete të shtuara duke përfshirë edhe modulën e tatimit në tokë. Qëllimi i zhvillimit të projektit është fuqizimi i komunave, duke rritur të hyrat e tyre vetanake, rrjedhimisht rritja e të hyrave nga tatimi në pronë. Ky projekt është dashur të përfundohet në fund të vitit 2017, mirëpo në muajin shkurt të vitit 2018 është nënshkruar marrëveshja për vazhdimin e përmirësimit të sistemit të tatimit në pronë "Pro Tax 2".

Trendi i rritjes së të hyrave nga tatimi në pronë për vitet 2010-2016



Edhe pse sistemi nuk është plotësisht efektiv, projekti ka ndikuar në rritjen e të hyrave nga tatimi në pronë, duke arritur qëllimin e tij kryesor. Ashtu siç është pasqyruar në grafikun me lartë të hyrat nga tatimi në pronë nga viti 2010 në vitin 2016 janë rritur 86%.

Baza e të dhënave të tatimit në pronë është e vendosur në MF e cila bën zhvillimin dhe mirëmbajtjen e saj¹². Po ashtu, pronësia dhe përgjegjësitë rreth SITP-së, do të kalojnë MF-së pas përfundimit të

¹² U.A 10/2011

projektit ProTax2.¹³ Ndërsa, komunat e Republikës së Kosovës apo niveli lokal, do të jenë shfrytëzuesit dhe përfituesit fundorë të këtij sistemi. Prej 38 komunave në Kosovë, 34 komuna¹⁴ e shfrytëzojnë sistemin.

1.1 Problemi i auditimit

SITP është sistem informativ i centralizuar. Ky sistem ka sjellë përmirësim në ofrimin e shërbimeve, bashkë me to ka sjellë edhe rreziqe të ndryshme lidhur me informatat të cilat i përpunon.

Ekzistojnë indikatorë të ndryshëm të problemeve të ndërlidhura me SITP. Një numër i caktuar i problemeve të ndërlidhura me sistem janë identifikuar nga Raportet vjetore të auditimeve të Pasqyrave Vjetore Financiare të komunave të kryera nga ZKA për vitin 2016¹⁵.

Raportet vjetore të auditimit për komunat kanë paraqitur të gjeturat sa i përket të hyrave nga tatimi në pronë dhe llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë. Disa nga këto mangësi janë:

- Mosbarazimet e raporteve të ProTaxit me shënimet e Thesarit,
- Mosbarazimet e kartelave financiare individuale të tatimpaguesve me raportin e ngarkesës dhe inkasimit,
- Mosbarazime nga falja e borxheve, të arkëtueshmeve nga tatimi në pronë, sistemi softuerik i të cilave menaxhohet nga Departamenti Qendror i Tatimit në Pronë, pranë MF, kohëve të fundit është vazhdimisht duke iu nënshtruar ndërhyrjeve në sistem për të harmonizuar ndikimet nga falja e borxheve dhe si proces është mjaft sfidues;
- Tatimpagues që posedonin dy apo më tepër prona të regjistruara, për secilën pronë ju kishte aplikuar zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës duke e konsideruar secilën si banim primar.


Gjatë vitit të kaluar në media është raportuar për ndërhyrje të paautorizuar në SITP.¹⁶ Një indikatorë tjetër është edhe numri i ankesave që është bërë nga qytetarët pranë bordeve të ankesave në komunat përkatëse.

¹³ Plani i veprimtimit të projektit ProTax2

¹⁴ Katër komunat që nuk e përdorin sistemin janë komunat në veri të Kosovës: Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku.

¹⁵ <http://zka-rks.org/publications/>

¹⁶ <http://archive.koha.net/?id=27&l=138272>

Grafiku 1: Numri i ankesave të tatimpaguesve te bordi i ankesave

Në grafikun më lartë është paraqitur numri i ankesave nga tatimpaguesit që kanë adresuar ankesat drejt Bordit të Ankesave nëpër komuna.

Përveç ankesave që paraqiten nga qytetarët tek bordi i ankesave, gjatë fazës së planifikimit ekipi ka bërë vëzhgim ku ka identifikuar një numër të madh të ankesave nga qytetarët, ankesa të cilat nuk adresohen përmes këtij bordi, mirëpo, adresohen drejtpërdrejt tek zyrtarët e tatimit në pronë në komuna. Fluksi i madh i ankesave janë vërejtur në muajin mars dhe prill të vitit 2017, kur është bërë ndryshimi i kartelës financiare ku në disa raste gjendja e faturave të tatimpaguesve ka ndryshuar brenda ditës.

Shqyrtimi i indikatorëve të problemit të identifikuar nga burime të ndryshme, na orienton në përkufizimin e problemit të auditimit: Efektiviteti i sistemit informative të tatimit në pronë.

1.2 Objektiva e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është të vlerësohet nëse ekziston një mjedis efektiv i kontrollit në mes të strukturave udhëheqëse dhe proceseve institucionale që sigurojnë se Sistemi Informativ i Tatimit në Pronë (SITP), mbështet qëllimet dhe strategjinë e institucionit, duke ofruar informacione të besueshme, të tërësishme dhe në kohë.

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për nivelin qendror, respektivisht MF-në dhe palët e tjera përgjegjëse në mënyrë që të përmirësohet qasja e tyre në raport me zbatimin dhe mbarëvajtjen e këtij sistemi, si dhe ofrimin e informatave të besueshme, të tërësishme dhe në kohën e duhur.

1.3 Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit ne kemi parashtruar pyetjen e auditimit si në vijim:

A është efektiv sistemi informativ i tatimit në pronë?

Për t' ju përgjigjur pyetjes kryesore më poshtë janë prezantuar pyetjet e auditimit:

Pyetja 1: A ekziston një mjedis efektiv i kontrollit për të siguruar se sistemi mbështet qëllimet dhe strategjinë e institucionit?

Pyetja 2: A janë të vlefshme të dhënat e vendosura në sistem për përpunimin e tyre? dhe

Pyetja 3: Sa është efektiv menaxhimi i shërbimeve?

1.4 Kriteret e auditimit

Për përcaktimin e kriterëve jemi bazuar në ligjet dhe rregulloret për tatimin në pronë, rregullore për organizim të brendshëm brenda MF-së¹⁷, marrëveshjen dhe planin e veprimit të projektit ProTax2 si dhe praktikën e mira ndërkombëtare të kontrollit të TI-së dhe auditimit të TI-së siç janë: COBIT 5 – Objektivat e Kontrollit të TI-së¹⁸, Manual i auditimeve të TI-së, për Institucionet Supreme të Auditimit¹⁹; dhe GTAG 8²⁰.

Më poshtë janë paraqitur kriteret duke u bazuar në pyetjet:

- Për mirëqeverisjen e TI-së, brenda organizatave duhet të ekzistojë një plan strategjik i TI-së i cili përkthen objektivat e biznesit në qëllimet dhe kërkesat e TI-së. Detyrë dhe përgjegjësi për hartimin e strategjisë së TI-së brenda MF-së është DMSTI;
- MF duhet të ketë strukturë organizative, ku roli dhe përgjegjësitë e TI janë të përcaktuara qartë si dhe TI është pozicionuar në një nivel të kënaqshëm brenda organizatës;
- MF, përkatësisht, DMSTI, harton dhe zbaton politikat dhe procedurat teknologjike në përputhje me ato të organizatës për të siguruar një operim efikas të departamenteve të veçanta, si dhe bashkëpunon me kryesuesit e departamenteve në hartimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e këtyre politikave. Gjithashtu, duhet të ekzistojnë mekanizma (nëpërmjet grupit të sigurimit të cilësisë, ose kontrole, etj.) me anë të të cilave siguron se janë duke u ndjekur të gjitha politikat dhe procedurat.

¹⁷ Rregullorja (QRK) - Nr.16/2016 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Financave;

¹⁸ COBIT, (Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë Informative), botim i Organizatës ndërkombëtare të Auditimit dhe Kontrollit të Sistemeve të Informacionit, ISACA (Information Systems Audit and Control Association), është një strukturë e përdorur gjerësisht, e cila përmbledh rekomandimet, praktikën dhe metodat më të mira të vlerësimit për kontrollet e përgjithshme IT, si dhe për programet që zhvillohen në këto ambiente;

¹⁹ Manuali i auditimeve të TI-së, për Institucionet Supreme të Auditimit;

²⁰ Global Technology Audit Guide (: Auditing Application Controls).

- Zhvillimi i SITP-së, duhet të realizohet në bazë të planit të veprimit, i cili udhëzon ekzekutimin e projektit;
- DTP duhet të ketë një procedurë sesi të identifikojë kërkesat e reja të biznesit ose nevojat e TI-së dhe Komiteti i Drejtimit, i cili aprovon këto kërkesa, duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për vendimmarrje;
- Rregullat e vlefshmërisë duhet të jenë të hartuara, dokumentuara dhe të zbatuara në vendosjen e të dhënave (input). Këto rregulla duhet të përditësohen në mënyrë sistematike si dhe të dhënat jo të vlefshme duhet të refuzohen në mënyrë të duhur nga aplikacioni.
- DTP duhet të ketë procedura për trajtimin dhe komunikimin e duhur të gabimeve të paraqitura në sistem. Gabimet duhet të trajtohen në mënyrë të përshtatshme dhe duhet të mundësohet gjurmimi i tyre.
- DTP duhet të hartojë politika dhe procedura për menaxhimin e qasjes së shfrytëzuesve. Nëpërmjet tyre bëhet ndarja për nivelet e autorizimit të transaksioneve, dhe kontrollohet zbatimi i tyre. Në rastet e pamundësisë të ndarjes së përgjegjësisë, duhet të ekzistojnë kontrollet kompenzuese.
- DTP duhet të sigurohet se të dhënat dalëse testohen për plotësi dhe saktësi para se ato të përpunohen apo procedohen më tutje. Gjithashtu, duhet të mundësohet gjurmimi i tyre.
- Ofrimi i shërbimit të përkrahjes së shfrytëzuesve, duhet të jetë i mbështetur me politika, procedura apo rregullore të punës.
- DMSTI në bashkëpunim me DTP-në, me anë të marrëveshjes së nivelit operacional, duhet të bëjë mbikëqyrjen e përditshme të performancës së sistemit, duke përcaktuar kufijtë kritik për matje dhe pritjet nga sistemi.
- MF, përkatësisht DTP duhet të posedoj procedura të hartuara dhe zbatuara për menaxhimin e ndryshimit.
- MF, përkatësisht DMSTI duhet të posedoj procedura për ruajtje të kopjes së të dhënave. Këto të dhëna duhet të testohen për mundësinë e rikthimit të tyre, si dhe të realizohen aftësi të personelit për vazhdimësi të punës.

1.5 Fushëveprimi i auditimit

Në këtë auditimi jemi fokusuar në efektivitetin e funksionimit të SITP-së, i cili është i vendosur në MF. Subjekt kryesor i këtij auditimi është MF, përkatësisht, DTP i cili është përgjegjës për zbatimin, operimin dhe krijimin e resurseve të nevojshme për mbarëvajtjen e SITP-së, duke siguruar që informacionet e përpunuara janë të besueshme, të tërësishme dhe në kohë. Si dhe DMSTI, përgjegjës për hartimin e politikave, procedurave, projekteve dhe strategjive për funksionimin normal dhe sa më cilësor të TI-së. Ndërsa marrë parasysh që sistemi është i centralizuar për të evidentuar gjendjen e zbatimit të projektit janë përzgjedhur katër komuna si

shfrytëzuese/përdorues të sistemit: Komuna e Prishtinës, Graçanicës, Pejës, si dhe Gjakovës²¹ Përzgjedhja e këtyre komunave si raste është bërë për arsyet e shpalosura më poshtë.

Komuna e Prishtinës është komuna më e madhe e cila vjelë më së shumti të hyra nga tatimi në pronë. Në vitin 2016, ka mbledhur rreth 7,2 milion.€.

Komuna e Graçanicës është përzgjedhur si komunë e vogël ku pjesëmarrja e saj në total është 1% e të hyrave nga tatimi në pronë në Kosovë.

Komuna e Pejës është përzgjedhur si komunë ku nga zyrtarët e komunës dyshohet se ka pasur ndërhyrje në sistemin e tatimit në pronë.

Komuna e Gjakovës gjatë vizitave në teren në fazën parastudimore është vërejtur se komuna e Gjakovës, është një komunë që menaxhon mjaftë mirë me të hyrat e tatimit në pronë si dhe është komuna e parë që ka aplikuar kriteret e vlerësimit të pronës, personeli është i mirë informuar për sistemin, kanë bërë kërkesa në DTP të vazhdueshme për përmirësim të sistemit, andaj është zgjedhur kjo komunë që mund të konsiderohet shembull i mirë. Gjithashtu, është komuna e parë që ka përdorur cilësinë e ndërtimit si bazë për kalkulim të tatimit.

Auditimi do të mbuloj periudhën nga fillimi i zbatimit të projektit në vitin 2009 deri në vitin aktual të auditimit 2017, ku janë analizuar modulet që janë aktualisht në funksion. Të gjitha mostrat dhe testimet në sistem i përkasin vitit 2017.

1.6 Metodologjia e auditimit

Për të kryer auditimin dhe për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve audituese ne kemi analizuar dokumentet, legjislacionin relevant dhe intervistuar palët përgjegjëse. Janë shqyrtuar praktikrat e mira ndërkombëtare dhe kemi kryer vëzhgime në terren.

Në kuadër të këtij auditimi ne kemi analizuar:

- Kornizën ligjore dhe rregullative lidhur me tatimin në prone;
- Raportet dhe hulumtimet që lidhen me fushën;
- Marrëveshjen e projektit ProTax2, planit të veprimit si dhe dokumentet e tjera të këtij projekti;
- Procesverbaleve të Komitetit Drejtues;
- Procesverbaleve të grupit të punës së projektit;
- Raportet tre mujore dhe vjetore të projekti ProTax2 të prezantuara në Komitetin Drejtues;
- Analizimi i detajuar i mostrave të përzgjedhura.

²¹ Në shtojcën 2 janë paraqitur të hyrat nga tatimi në prone për vitin 2016 dhe pjesëmarrja e komunave në bazë të të cilave është bërë përzgjedhja

Janë zhvilluar intervista me palë të ndryshëm të përfshirë në SITP duke përfshirë:

- Intervista me drejtorët e departamenteve të MF-së; përfshirë këtu drejtorin e departamentit të tatimit në pronë, drejtorin e departamentit të departamenti për menaxhimin e sistemeve të Teknologjisë Informative;
- Intervistë me administratorin e sistemit;
- Intervista me të punësuarit në projektin ProTax përfshirë këtu, menaxherin e projektit, zëvendës menaxherin e projektit për biznes dhe zëvendës menaxherin e projektit për TI, analistë të sistemit, zhvillues të sistemit, testues të sistemit, zyrtarët e tavolinës ndihmëse, programerët etj;
- Intervista me kryetarin e Komiteti drejtues të projektit;
- Intervistë me udhëheqësin divizioni i infrastrukturës së TI-së;
- Intervista me zyrtarët për tatim në pronë në ZKTP për komunitat e përfshira në auditim; drejtorët financiar menaxherët/ udhëheqësit e tatimit në pronë, udhëheqës të operacioneve, zyrtaret e futjes së të dhënave në sistem, anketuesit, bordin e ankesave, zyrtarët e TI-së.

2 Përshkrimi i procesit, palët përgjegjëse dhe trupat mbështetës për zbatimin e SITP-së

Standardet dhe procedurat të cilat duhet t'i respektojnë komunat gjatë administrimit të tatimi mbi pronën e paluajtshme, janë të rregulluara me Ligjin Nr. 03/L-204 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (LTPP). Ndërsa, të hyrat e mbledhura nga tatimi mbi pronën e paluajtshme arkëtohen në llogari të komunës përkatëse dhe përdoren nga ajo në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal²².

LTPP, përcakton parimet, rregullat themelore dhe organet përgjegjëse për administrimin dhe monitorimin e funksionimit të tatimit në pronë. Aspekte të ndryshme të procesit të tatimit në pronë janë rregulluar në mënyre të detajuar me aktet nënligjore të nxjerra nga MF, ku deri më tani janë hartuar tetë U.A. Ndërsa, komuna në baza vjetore miraton rregullore për vendosjen e tatimit në pronë përfshirë bazën tatimore, zonat si dhe vlerën e tregut për zonat.

Ministria e Financave

Baza e të dhënave e tatimit mbi pronë është e vendosur në sistemin qendror për tatimin në pronë e cila është zhvilluar dhe mirëmbajtur nga MF. Brenda MF-së, janë dy departamente të cilat kanë përgjegjësi lidhur me mbarëvajtjen e SITP-së.

Departamenti i tatimit në pronë (DTP), udhëheqë dhe mbikëqyr punën për zbatimin e legjislacionit në komunat e Kosovës. Roli i saj është që t'ju ofroj përkrahje komunave duke monitoruar administrimin e tatimit në pronë, duke zbatuar sistemin për menaxhimin e administrimit të tatimit në pronë dhe zhvilluar softuerin e TP. Gjithashtu ky departament bën dhe vendos në sistem normat dhe çmimet tatimore për secilin vit, aprovon qasjen në sistem dhe regjistron pagesat në sistem në formë elektronike.

Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative (DMSTI) është përgjegjëse për hartimin e strategjive, politikave, procedurave, projekteve për funksionimin normal dhe sa më cilësor të TI-së brenda MF-së. Ky departament është përgjegjëse edhe për monitorimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të rrjetit, sistemit dhe aplikacioneve të MF-së. Po ashtu është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e përditshme të aplikacioneve të punës, sigurimin e disponueshmërisë dhe performancës sipas Marrëveshjeve të Nivelit Operacional (MNO) me departamentet dhe divizionet tjera përkatëse; etj.

²² Të hyrat e vjela nga Tatimi mbi Pronën e Paluajtshme arkëtohen në llogarinë kryesore të Thesarit dhe më pastaj identifikimi dhe bartja e tyre tek komunat bëhet duke shfrytëzuar kodin e UNIREF-it për identifikim të tyre.

Komunat

Çdo komunë duhet të themelojë dhe të mbajë një bazë të dhënash lidhur me tatimin mbi pronën, duke përfshirë; adresat e pronës, adresat e poseduesve dhe të shfrytëzuesve të pronës, të dhënat mbi tokën dhe ndërtesat, vlerat e pronës, faturat e pronës dhe shënimet mbi pagesat e tatimit.

Pra, komunat janë përgjegjëse për menaxhimin e informatave tatimore mbi pronën dhe futjen e të dhënave në bazën Qendrore; përfshirë këtu mirëmbajtjen, ruajtjen dhe freskimin e përhershëm të të dhënave, anketimin e objekteve të reja që janë në ndërtim e sipër, vlerësimin e paluajtshmërive, lëshimin e faturave, shqyrtimin dhe menaxhimin e ankesave si dhe grumbullimin e mjeteve.

Trupat mbështetës të projektit për SITP-në

SITP zhvillohet në bazë të marrëveshjes, në mes të MF-së, ATS dhe financim të SIDA-as. Sipas marrëveshjes pronare e projektit është MF. Kjo marrëveshje ka paraparë që projekti të zhvillohet sipas planit të projektit. Organet dhe ekipet që e mbështesin projektin janë të prezantuara në vijim.

Komiteti Drejtues është organi suprem vendimmarrës i projektit. Ky komitet ka një rol të rëndësishëm në drejtimin e rezultateve të projektit dhe punës. Komiteti drejtues, vendos, pas miratimit nga SIDA, mbi ndryshimet e mundshme në planin kohor, rezultatet e projektit dhe buxhetin e përcaktuar si dhe miraton specifikimet dhe zbatimin e rezultateve të ndryshme të projektit të planifikuar të propozuara nga projekti.

Grupi Menaxhues i Projektit (GMP) është organi ekzekutiv i projektit. Ai ka mandatin të marrë vendime brenda këtij plani të projektit.

Ekipi i Zhvillimit të Punës ka përgjegjësinë kryesore për katër nga pesë rezultatet e projektit, përmirësimin e rregulloreve të tatimit në pronë, proceset e reja të punës, zgjerimin e regjistrave të pronës etj. Ky ekip gjithashtu është përgjegjës për vendosjen e kërkesave të nivelit të lartë në sistemin TI.

Ekipi i Zhvillimit të TI-së ka përgjegjësinë kryesore për rezultatin e projektit dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit të TI. Ai gjithashtu është përgjegjës për pjesëmarrje në dizajnimin e proceseve të punës nga perspektiva e gjetjes së zgjidhjeve. Ekipi i Zhvillimit të TI-së ka një përgjegjësi konkrete në transferimin e njohurive tek ekipi i Mirëmbajtjes së TI.

Ekipi i operimit dhe mirëmbajtjes së TI ka për qëllim që në mënyrë të pavarur të operoj dhe mirëmbaj sistemin TI të TP. Pas projektit, ekipi i mirëmbajtjes së TI është gjithashtu përgjegjës për zhvillime të mëtutjeshme të mundshme të sistemit TI. Ky ekip duhet të përbehet nga pesë persona, si dhe anëtarët e këtij ekipi duhet të punësohen dhe financohen në mënyrë permanente nga MF dhe vendosen në DMSTI.

3 Gjetjet e auditimit

Në këtë pjesë të raportit janë të prezantuara gjetjet e auditimit që ndërlidhen me SITP. Ky kapitull fillimisht trajton qeverisjen e TI-së, duke përfshirë gjetjet që ndërlidhen me strategjinë e TI-së, strukturën organizative, politikat dhe procedurat për zhvillimin dhe funksionimin e SITP-së. Më tutje, ky kapitull paraqet gjetjet që ndërlidhen me efektivitetin e kontrollit, përfshirë këtu vlefshmërinë e të dhënave të vendosura në sistem dhe përpunimi i tyre, duke filluar nga të dhënat hyrëse (inputi), procesimi i transaksioneve dhe të dhënat dalëse (outputi), procedurat për trajtimin e gabimeve dhe deri te siguria e aplikacionit.

Kjo pjesë e raportit finalizohet me gjetjet e auditimit që ndërlidhen me menaxhimin e shërbimeve, fillimisht janë paraqitur gjetjet lidhur me kërkesat e përdoruesve, matja e performancës së sistemit, vendosja e kufijve kritik për matje dhe krahasim të rezultateve, mekanizmat për menaxhimin e ndryshimeve si dhe ruajtja e të dhënave në kopje rezervë.

3.1 Qeverisja e TI-së dhe roli i saj në zhvillimin, funksionimin dhe operimin e SITP-së

Qeverisja e TI-së²³ përkufizohet si struktura e përgjithshme që udhëheq operacionet e TI-së në një organizatë për të siguruar se përpunohen me nevojat e biznesit dhe ka plane për nevojat e së ardhmes. Një strukturë e përgjithshme e qeverisjes së TI-së përfshinë: strategjinë dhe planifikimin e TI-së, strukturat organizative, standardet, politikat dhe procedurat e organizatës, zhvillimi dhe blerja etj.

3.1.1 Strategjia e Teknologjisë Informative

Për mirëqeverisjen e TI-së²⁴, brenda organizatave duhet të ekzistojë një plan strategjik i TI-së i cili përkthen objektivat e biznesit në qëllimet dhe kërkesat e TI-së. Përgjegjës për hartimin e kësaj strategjie brenda MF-së është DMSTI.²⁵

MF nuk ka hartuar një plan Strategjik për TI-në përmes të cilit do të përcaktohej se si TI do të ndihmojë në arritjen e objektivave strategjike të institucionit, shpenzimet dhe rrezikun lidhur me të. Në bazë të intervistave me zyrtarët e departamentit të DMSTI-së në MF²⁶ janë ndërmarr iniciativa për hartimin e kësaj strategjie, mirëpo, ne nuk na është ofruar dëshmi për këtë.

Mungesa e një plani strategjik i TI-së ka ardhur si pasojë e përcaktimit të paqartë të zbatimit të objektivave të MF-së për menaxhimin e TI-së. Gjithashtu, në mungesë të strategjisë, MF nuk ka arritur t'i përmbush edhe kërkesat për SITP siç është paraparë më marrëveshjen e projektit "ProTax2"²⁷.

²³ Qeverisja e TI-së luan një rol kyç në përcaktimin e mjedisit kontrollues dhe vendos themelet për ndërtimin e një praktike të mirë në kontrollin e brendshëm si dhe në raportimin në nivelet funksionale mbikëqyrjen dhe rishikimin menaxherial.

²⁴ Sipas COBIT-it, Qeverisje e TI-së nënkupton udhëheqjen strukturën organizative dhe proceset që sigurojnë që strategjia e IT-së ecë në përputhje me strategjinë dhe objektivat e organizatës.

²⁵ Rregullore nr. 16/2016 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MF

²⁶ Intervistë me udhëheqësin e divizionit për infrastrukturë të TI-së në MF, tetor 2017

²⁷ Marrëveshja dhe plani i veprimit për ProTax do trajtohet më poshtë

3.1.2 Struktura organizative, politikat dhe procedurat për zhvillimin e SITP-së

Strukturat e organizatës, politikat dhe procedurat janë një element kyç i qeverisjes së TI-së. Prandaj, për të siguruar qeverisje të mirë të TI-së, MF duhet të ketë strukturë organizative, ku roli dhe përgjegjësitë e TI janë të përcaktuara qartë si dhe TI është pozicionuar në një nivel të kënaqshëm brenda organizatës. Ndarja roleve dhe përgjegjësi është çelësi për qeverisje efektive²⁸, prandaj për të arritur këtë MF ka hartuar rregulloren për organizimin e brendshëm, me anë të cilës rolet dhe përgjegjësitë e TI-së janë pozicionuar qartë. Mirëpo, kjo rregullore nuk ka gjetur zbatim, pasi që sipas kësaj rregullore, DMSTI është i ndarë në tri divizione: divizioni për infrastrukturë, për operime dhe për menaxhim të aplikacioneve. Mirëpo, në divisionin për menaxhimin e aplikacioneve nuk ka personel i cili do të mbështesë DTP-në zhvillimin e aplikacionit. Aktualisht, për përkrahje të projektit prej MF-së si personel i MF-së është i angazhuar vetëm një punonjës në pozitën: Administrator i sistemit²⁹. Në mungesë të personelit nga MF përkatësisht nga DMSTI dhe DTP, për të mundësuar funksionimin e sistemit shumë detyra kryhen nga ekipi projektit. Ne kemi vërejtur se shumë funksione si p.sh korrigjimi i të dhënave financiare, administrimi i bazës së të dhënave, kryhen nga programerët apo personel tjetër i projektit. Kjo vështirëson funksionimin normal të punës së tyre, por edhe ndikon në zvogëlimin e llogaridhënies dhe sigurisë së të dhënave.

Departamenti përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave të TI-së në MF, DMSTI nuk ka arritur të hartoj politika dhe procedura të brendshme për operacionet e TI-së. Edhe pse ky departament ka bërë përpjekje për hartimin e dy procedurave të TI-së, këto procedura nuk janë të aprovuara. Në mungesë të tyre, DTP nuk ka politika dhe procedura për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemit. Gjithashtu, mungojnë edhe politikat dhe procedurat për personelin e projektit, për kontrollin e aktiviteteve dhe funksioneve të TI-së, si dhe procedura për garantimin e mbrojtjes së të dhënave.

3.1.3 Shtrirja e sistemit

Aktualisht, prej 38 komuna në Kosovë, sistemin e shfrytëzojnë 34 komuna. Katër komunat që nuk e përdorin sistemin janë komunat në veri të Kosovës: Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku. Këto komuna nuk mbledhin të hyra nga tatimi në pronë që nga viti 2008. Bazuar në intervistat me zyrtarët e MF-së, dy vitet e fundit, Ministria e Financave, përkatësisht DTP përmes USAID ka mbajtur disa takime me kryetarët e këtyre komunave, me qëllim të promovimit të interesave që kanë komunat nga mbledhja e të hyrave nga tatimin në pronë, mirëpo mungon vullneti i komunave për bashkëpunim. Vlen të përmendet që DTP dhe projekti është i gatshëm teknikisht të ofroj shtrirjen e sistemit edhe në këto komuna.

²⁸ COBIT

²⁹ Për përkrahjen e projektit nga MF, më gjerësisht shtjellohet në të gjeturën e radhës

3.1.4 Zhvillimi i projektit, strukturat udhëheqëse dhe mbikëqyrja e projektit


SITP zhvillohet në bazë të marrëveshjes³⁰ dhe planit të veprimit ProTax³¹. Projekti, ka për qëllim të regjistroj të gjitha parcelat si prona dhe të përmirësoj sistemin e tatimit në pronë në përgjithësi. Organi vendimmarrës i projektit është komiteti drejtues³². Ky komitet duhet të takohet së paku tri herë në vit³³. Mirëpo, nga viti 2014 deri në muajin tetor 2017, KD ka mbajtur vetëm gjashtë takime.

Në vitin 2016 është takuar vetëm dy herë ndërsa në 2017 është mbajtur vetëm një takim³⁴ për të diskutuar për projektin. Në tri nga gjashtë takimet e KD, nuk ka marrë pjesë kryesuesi i komitetit, që njëkohësisht përfaqëson edhe të deleguarin e MF-së si dhe nuk ka deleguar ndonjë zyrtar tjetër për të marrë pjesë në takim. Si rrjedhojë e kësaj zbatimi i projektit është përcjell me pengesa.

Për të siguruar qëndrueshmëri të projektit, marrëveshja dhe plani i veprimit për ProTax2, kanë paraparë edhe plotësimin e disa kushteve nga palët e përfshira.

- Plani i projektit ka paraparë që të zhvillohet në disa faza ashtu siç është paraqitur në figurën më poshtë.

Figura 1 - Afatet kohore për realizimin e fazave



- Ashtu siç janë paraqitur në figurën më lartë projekti ka planifikuar që aktivitetet të zhvillohen sipas fazave ku janë paraparë edhe afatet kohore për përfundimin e tyre. Mirëpo, punët nuk janë kryer sipas planifikimit. Projekti ka paraparë që planin kohorë ta ndajë në disa faza. Faza e fillimit, faza e specifikimeve, faza 1,2 si dhe faza e tranzicionit. Një ndër arsyt e mos

³⁰ Marrëveshja e projektit, mes MF-së dhe Agjencisë Tatimore Suedeze, dhe marrëveshja e kontributit mes SIDA dhe MF-së lidhur me mbështetjen për ProTax2 me datë 13.05.2014

³¹ Plani i veprimit, ProTax2, Projekt për Vazhdim të Përmirësimit të Sistemit të Tatimit në Pronë në Kosovë,

³² Plani i veprimit, ProTax2, Projekt për Vazhdim të Përmirësimit të Sistemit të Tatimit në Pronë në Kosovë,

³³ Plani i veprimit, ProTax2, Projekt për Vazhdim të Përmirësimit të Sistemit të Tatimit në Pronë në Kosovë,

³⁴ Deri në muajin tetor 2017, KD drejtues është takuar vetëm një here.

përfundimit të fazës së parë është mos miratimi i ligjit për tatim në tokë³⁵. Gjithashtu, ndikim të madh ka pasur edhe vendimi i qeverisë për faljen e borxheve³⁶.

- Është paraparë që DMSTI në MF të angazhojë që nga fillimi i projektit edhe pesë pozita për zhvillimin e sistemit siç janë: dy programer, test menaxher, analist sistemit, menaxher i Infrastrukturës së TI-së. Mirëpo, MF ende nuk ka angazhuar personel për të plotësuar pozicionet e kërkuara sipas marrëveshjes për nevojat e SITP-së;
- Bazuar në planin e veprimit, projekti nuk do të operoj me sistemin e TI-së të tatimit në pronë pas fazës së Specifikimeve³⁷ si dhe nuk do të mirëmbaj sistemin e teknologjisë informative të tatimit në pronë- pas përfundimit të fazës 1. Nga ekipi i projektit është bërë kërkesë për plotësimin e nevojave për infrastrukturë, mirëpo MF, nuk ka arritur të sigurojë infrastrukturën e nevojshme. Sipas KD, TI brenda MF-së është duke përgatitur një plan strategjik për përmirësimin e infrastrukturës ku do të përfshihet edhe nevojat e këtij sistemi, mirëpo edhe pse ky zotim është bërë në mars të 2015, kjo asnjëherë nuk është realizuar dhe tenderi ka dështuar. Edhe në këtë rast, projekti ka kryer vetë disa investime të nevojshme për të mos lejuar dështimin e sistemit, ndërsa MF ka përkrahur projektin vetëm me infrastrukturën e ekzistuese.
- DTP është dashur të angazhojë dy punonjës për tavolinë ndihmëse, mirëpo funksioni i tavolinës ndihmëse aktualisht plotësohet me punonjës të përkrahur nga projekti.

Të gjitha këto shqetësime janë adresuar nga ekipi i projektit edhe tek KD, mirëpo MF nuk ka arritur ende të plotësojë këto kushte. Mungesa e personelit për nevojat e SITP-së ka bërë që ekipi i projektit të kryejë punë shtesë që nuk janë paraparë, gjë që vështirëson kryerjen e punës sipas planit.

3.1.5 Identifikimi i kërkesave për ndryshime

DTP duhet të ketë një procedurë për identifikimin dhe trajtimin e kërkesave të reja të SITP-së³⁸ dhe Komiteti Drejtues³⁹, i cili aprovon këto kërkesa, duhet të ketë informata të mjaftueshme për vendimmarrje. Mirëpo, DTP ende nuk ka hartuar procedura për identifikimin e kërkesave për ndryshime.

Komiteti drejtues është organ përgjegjës për ndryshimin e planit kohor si dhe aprovimin e ndryshimeve të tjera pas aprovimit nga SIDA. Gjatë auditimit na është prezantuar një plan kohor i projektit, i cili nuk është azhurnuar me ndryshimet e afateve kohore të projektit. Projekti ka pësuar ndryshime në afatet kohore për shkaqet që u përmendën më lartë⁴⁰.

Një prej kërkesave për ndryshim që do të duhej të merrte aprovim nga KD, marr parasysh faktin se ka ndikuar në shtyrjen e planit të projektit është zhvillimi i faljes së borxheve. Falja e borxheve ka

³⁵ Intervistë me kryetarin e komitetit drejtues, maj 2017

³⁶ Falja e borxheve trajtohet më gjerësisht më poshtë

³⁷ Është planifikuar të fazat të kryhet: faza e planifikimit, në 2014, Faza e specifikimi 2014; ndërsa faza e I-rë gjatë vitit 2015, faza 2 në 2016, faza e tranzicionit gjatë vitit 2017.

³⁸ Manual i auditimeve të TI-së, për Institucionet Supreme të Auditimit;

³⁹ Komiteti drejtues i projektit është organ vendimmarrës i projektit

⁴⁰ Referoju të gjeturës 3.1.3

ardhur si vendim i Qeverisë⁴¹, prandaj zhvillimi i këtij moduli ka qenë i domosdoshëm. Mirëpo, ky modul ka qenë mjaft sfidues për projektin, pasi që shumica e punëve të planifikuara me plan është dashur të shtyhen. Ne kemi vlerësuar se komiteti nuk ka aprovuar ndonjë ndryshim të planit si pasojë e faljes së borxheve, apo të ketë kërkuar ndonjë plan të ri pas ndryshimeve për faljen e borxheve. Nga minutat e takimit ne kemi vërejtur se falja e borxheve vetëm është diskutuar më pas si shkaktar i shtyrjes së planit të projektit⁴².

Projekti ka azhurnuar planin me ndryshimet e nevojshme, dhe ky plan ende nuk është miratuar nga KD. Vlen të theksohet se projekti e vazhdon punën bazuar në planin e ri.

Gjithashtu, edhe ndryshime të tjera janë bërë pa ndonjë aprovim formal të menaxherit të projektit apo DTP-së.

- Ne kemi vërejtur se janë ndërmarrë aktivitete për zëvendësimin e modulit financiar⁴³ nga ekipi punues (zhvillimit të punës dhe të TI-së në kuadër të projektit), aktivitete për të cilat nuk kemi hasur në dëshmi apo vendim se janë diskutuar edhe me zyrtarët e DTP-së, apo me menaxherin e projektit dhe KD.
- DTP nuk ka ndonjë plan për identifikimin e kërkesave dhe KD nuk ka hartuar vendime të shkruara për çështje të caktuara lidhur me ecurinë e projektit apo kërkesave të tjera. Në mungesë të planit nuk ka as listë të kërkesave të identifikuara, e cila do ti ndihmonte në prioritizimin e tyre sipas rëndësisë dhe do të lehtësonte vendim marrjen lidhur me realizimin.
- Në mungesë të procedurave ka raste kur komunat bëjnë kërkesa për ndryshime vetëm me anë të telefonit, pa ndonjë kërkesë zyrtare. Kërkesat për ndryshimet e tjera që vijnë nga shfrytëzuesit, drejtohen drejtpërdrejtë te ekipi i punës⁴⁴ për trajtim të mëtutjeshëm. Për trajtimin e tyre vendoset në bazë të momentit nga ky ekip, ku në bazë të minutave të takimit ne nuk kemi vërejtur se në këto takime merr pjesë menaxheri i projektit.

3.2 Efektiviteti i kontrolleve të aplikacionit

Aplikacioni i tatimit në pronë i quajtur "ProTax" është aplikacion⁴⁵ i zhvilluar nga ekipi i projektit, në gjuhën programuese Java, me bazën e të dhënave në MySQL dhe punon në platformën Web. Qasja në aplikacion mund të bëhet brenda rrjetit të domenit Qeveritar dhe mund të hapet nga cilido kompjuter brenda rrjetit.

⁴¹ Moduli I faljes së borxheve shtjellohet më poshtë

⁴² Për planin kohor të projektit flitet në procesverbalin e marsit të vitit 2016.

⁴³ Ndryshimi i modulit ka qenë i paraparë sipas planit, mirëpo për shkak të ndryshimit të planit është përfunduar në vitin mars 2017

⁴⁴ Ky ekip, mban takime së paku dy herë në javë

⁴⁵ Aplikacioni është një program specifik që përdoret për të mbështetur një proces të caktuar të institucionit, duke përfshirë procedura si manuale ashtu edhe të kompjuterizuara për krijimin e transaksionit, procesimin e të dhënave, mbajtjen e regjistrimeve dhe përgatitjen e raportit

Kontrolli i aplikacionit⁴⁶ përfshin disa fusha siç është paraqitur në figurën e mëposhtme.

Figura 2-Kontrollet e aplikacioneve





Figura në vijim paraqet proceset e përfshirë në auditim nga secila kategori.

Figura 3- Proceset e përfshira në auditim nga secila kategori



3.2.1 Të dhënat hyrëse

Për të siguruar të dhëna hyrëse të sakta, të besueshme, të plota dhe ato të pranohen nga aplikacioni brenda kohës së caktuar, aplikacioni duhet të posedoj mekanizma të kontrollit. Të dhënat hyrëse

⁴⁶ Manuali i auditimit të TI-së për institucionet supreme të auditimit

përfshin vlefshmërinë e të dhënave në hyrje, procedurat për trajtimin e gabimeve, autorizimi i vendosjes së të dhënave. Mangësitë e identifikuar në të dhënat hyrëse janë paraqitur në vijim.

Vlefshmëria e të dhënave në hyrje

DTP duhet të ketë rregulla për vlefshmërinë e vendosjes së të dhënave në hyrje, të cilat duhet të jenë të hartuara, dokumentuara si dhe duhet të krijojë mekanizma për të kontrolluar zbatimin e tyre. Këto rregulla duhet të përditësohen në mënyrë sistematike si dhe të dhënat jo të vlefshme duhet të refuzohen në mënyrë të duhur nga aplikacioni⁴⁷. Gjatë testimit të vlefshmërisë së të dhënave në hyrje, sistemi ka shfaqur disa mangësi të cilat janë paraqitur më poshtë:

- Anketuesit në teren përdorin pajisjet mobile, për regjistrimin e pronave, anketimin apo verifikim e tyre, duke u qasur në sistem nga terreni. Qasja realizohet duke shfrytëzuar rrjetën e operatorëve të telefonisë celulare. Këto pajisje përveç tjerash posedojnë edhe mundësinë e pranimit të informatave gjeografike të pozicionit. Mirëpo, këto pajisje kanë shfaqur shumë probleme. Fillimisht, në sistem janë të vendosura fotografitë apo imazhet gjeografike të njohura si ortofoto, të cilat aktualisht paraqiten në një format të vogël duke përfshirë vetëm ¼ e ekranit dhe ka mundësi të zmadhohet vetëm tri herë, duke e vështirësuar identifikimin e koordinatës së saktë të objektit.
- Ortofoto në sistem në pajisjen kompjuterike nuk ka funksionuar gjatë fazës së auditimit. Ndërsa, ortofotot e vendosura aktualisht në sistem janë realizuar në vitin 2010 dhe shumë objekte nuk paraqiten fare. Me pajisjen mobile në ortofoto nuk paraqitet ndonjë shenjë informuese e cila tregon nëse prona është e regjistruar apo jo.
- Po ashtu, në lokacionet në të cilat nuk ekziston mbulueshmëria e shërbimeve të telefonisë celulare, pajisjet mobile nuk ofrojnë të dhëna të sakta rreth objekteve në atë zonë. Në disa raste, janë realizuar matjet dhe fotografimet për të dëshmuar gjendjen dhe identifikuar objektet, mirëpo në pamundësi të qasjes në rrjet këto informata nuk janë transmetuar. Pas lëvizjes së anketuesve (operatorëve) dhe kthimit të tyre në zonat e mbuluara me shërbime celulare apo edhe zyre, është realizuar lidhja e këtyre pajisjeve me sistemin, mirëpo koordinatat gjeografike janë përcjell nga lokacioni ku ata aktualisht ishin të vendosur, e jo të lokacionit se ku janë mbledhur këto të dhëna.
- Në mungesë të ndonjë praktike të rekomanduar nga DTP, komunat përdorin praktika të ndryshme për trajtimin e kësaj çështje. Komuna e Prishtinës, nuk ka regjistruar fare pronat në vendet ku nuk ka mbulueshmëri të rrjetës. Ndërsa, komunat e tjera si Peja, Gjakova
- Graçanica i regjistrojnë këto prona, mirëpo koordinatat e tyre nuk janë të sakta, sepse regjistrimi i tyre bëhet në vendet ku pajisja mobile mund të kyçet në rrjetë. Gjithashtu, komunat si Prishtina dhe Gjakova, përdorin edhe Gjeoportalin për identifikim sa më të saktë të objekteve, ndërsa Peja dhe Graçanica nuk përdorin këtë aplikacion.
- Të gjitha këto mangësi vështirësojnë identifikimin e pikës së objektit si dhe nuk mundësojnë që përmes pajisjes mobile të bëhet identifikimi nëse prona është e regjistruar.

⁴⁷ Manuali i auditimit të TI-së për institucionet supreme të auditimit

- Aktualisht, është duke u punuar në përmirësimin e këtij moduli, mirëpo komunat ende përballen me këto vështirësi.
- Gjatë regjistrimit masiv të pagesave me datë 30 dhe 31 dhjetor të çdo viti, për vitet e mëparshme sistemi nuk ka pranuar automatikisht këto pagesa. Të gjitha këto pagesa është dashur të regjistrohen në mënyrë manuale nga komunat. Deri në muajin mars të vitit 2017, këto pagesa janë regjistruar duke shtuar vlerën e pagesës mbi një pagesë të mëparshme të tatimpaguesit. Në raportin e pagesave këto pagesa nuk figurojnë fare. Për gjetjen e këtyre pagesave duhet të kërkohen të gjitha transaksionet e kartelës. Kjo ka shkaktuar vështirësi të mëdha për zyrtaret e futjes së të dhënave nëpër komuna.
- Nga marsi i vitit 2017 është eliminuar kjo mangësi dhe mund të bëhet lidhja e këtyre pagesave.
- Në mungesë të identifikimit të pronës së regjistruar, e njëjta pronë ka mundësi të regjistrohet disa herë. Kjo për arsye se sistemi ende nuk përdor një funksion për identifikimin nëse ai tatimpagues ose ajo pronë është e regjistruar në sistem si p.sh letërnjoftimi, koordinata e objektit etj. Kjo do të shërbente si preventivë e regjistrimeve të dyfishta.
- Te tatimpaguesit që kanë më shumë se një pronë për banim, sistemi aplikon zbritjen prej 10,000 € për të gjitha pronat dhe i klasifikon ato si banim primar. Kjo është në kundërshtim me ligjin për tatimin në pronë⁴⁸, ku sipas tij vetëm për banimin primar lejohet zbritja prej 10,000 €.
- Sistemi nuk llogarit tatimin bazuar në cilësinë e ndërtimit. Në bazë të UA nr.03/2011 cilësia e ndërtimit është e shprehur në koeficient, e cila varësisht prej gjendjes së objektit⁴⁹ rritë apo e zvogëlon ngarkesën tatimore. Ne kemi verifikuar se kalkulimi i ngarkesës tatimore është bërë pa konsideruar cilësinë e ndërtimit. Nga komunat e përzgjedhura, vetëm Gjakova aplikon këtë kriter që nga viti 2009. Edhe pse përdorimi i këtij kriteri është paraparë me U.A, sipas zyrtarëve të DTP-së, komunat deri më tani janë vet deklaruar për të përdorur kriterin apo jo. Vetëm nëntë nga 34 komuna janë duke përdoruar këtë kriter. Sipas DTP-së të gjitha komunat do ta aplikojnë kriterin nga viti 2018. Mospërdorimi i cilësisë si bazë për tatim ka ndikim financiar në disa raste në dëm të komunës, në disa raste në dëm të qytetarit.
- Manuali i përdorimit në sistem nuk është i përditësuar. Në sistem janë lëshuar funksione të reja mirëpo manuali nuk është përditësuar siç janë kartela financiare, raportet, bartja e pagesave, etj.

Procedurat për trajtimin e gabimeve

DTP duhet të ketë procedura për trajtimin dhe komunikimin e duhur të gabimeve të paraqitura në sistem. Gabimet duhet të trajtohen në mënyrë të përshtatshme dhe duhet të mundësohet gjurmimi

⁴⁸ Ligji për tatimin në pronë, neni 9

⁴⁹ Cilësia e ndërtimit klasifikohet në disa kategori si shumë e dobët, e dobët, mesatare, e mirë dhe e shkëlqyeshme

i tyre⁵⁰. DTP nuk ha hartuar politikat dhe procedurat për trajtimin e të dhënave të refuzuara dhe procedura për rishikimin e dosjeve në pezullim.

Gjatë testimit në sistem, për shfaqjen e një raporti, kemi vërejtur se në rastin kur nuk është shfaqur raporti është paraqitur mesazhi i gabimit “Veprimi i kërkuar nuk mund të ekzekutohet”. Në këtë mesazh në vazhdim nuk ka pasur numër të llojit të gabimit, datën dhe kohën kur ka ndodhë gabimi apo edhe ndonjë arsyetim për paraqitjen e këtij gabimi.

Për më shumë të bashkangjitur me këtë mesazh nuk ishin shfaqur e-maili zyrtar i ndonjë zyrtari të DTP-së mirëpo emaili privat i ekipit të projektit dhe numrat e telefonit personal. Gjithashtu, këto gabime nuk janë të gjurmueshme pasi nuk kanë kod të gabimit apo ndonjë veçori tjetër identifikuese dhe nuk ruhen në bazën e të dhënave të sistemit. Nuk mund të identifikohet se çfarë gabimi ka ndodhur gjatë transaksionit dhe nga kush është kryer ai transaksion. Sipas zyrtarit të tavolinës ndihmëse, identifikimi i gabimit apo natyrës së tij, bëhet vetëm kur kontaktohen dhe pyeten përdoruesit së çfarë ishin duke ekzekutuar.

Sistemi nuk ofron një listë me llojet e gabimeve dhe mesazheve për identifikim e tyre, ku shfrytëzuesi në rast se gjatë procesimit të transaksionit ndodhë ndonjë gabim të ketë mundësi ta lexon numrin dhe ta njofton zyrtarin e tavolinës ndihmëse se cili gabim ka ndodhur.

Autorizimi i vendosjes së të dhënave në aplikacion

Procedurat e shkruara për menaxhimin e qasjes së shfrytëzuesve përcaktojnë ndarjen për nivelet e autorizimit të transaksioneve, si dhe mundësojnë që të kontrollohet zbatimi i tyre. DTP nuk ka hartuar procedura për menaxhimin dhe autorizimin e shfrytëzuesve. Për më shumë për të shfrytëzuar sistemin, nuk ka procedura të trajnimit dhe certifikimit për njohje të sistemit dhe zyrtarët nuk janë të obliguar që fillimisht të trajnohen e më pas të kenë qasje në sistemi.

Për t’ju mundësuar qasja në sistem përdoret një formë që plotësohet nga ZKTP, ku përcaktohen rolet. Administratori i sistemit e merr formën e nënshkruar nga menaxheri i komunës, aprovimin nga udhëheqësi i divizionit dhe e realizon kërkesën sipas formës së nënshkruar.

3.2.2 Plotësia dhe saktësia e të dhënave në dalje

DTP duhet të sigurohet se të dhënat dalëse testohen për plotësi dhe saktësi para se ato të përpunohen apo procedohen më tutje. Gjithashtu, duhet të mundësohet gjurmimi i tyre⁵¹.

Gjatë kontrollit të saktësisë dhe plotësisë të dhënave në dalje, në bazë të mostrave të përzgjedhura janë identifikuar disa mangësi të cilat janë paraqitur në disa grupe: Regjistrimi i pagesave; shpërndarja e pagesës; fatura e tatimit në pronë; kartela financiare; moduli i faljes së borxheve si dhe raportet.

⁵⁰ Manuali i auditimeve të TI-së, për Institucionet Supreme të Auditimit

⁵¹ Manuali i auditimeve të TI-së, për Institucionet Supreme të Auditimit.

Regjistrimi i pagesave, mosbarazimet, vonesat në regjistrim dhe pagesat e dështuara

Regjistrimi i pagesave masive në sistem bëhet në mënyre manuale nga DTP pas marrjes së raportit nga Thesari, çdo ditë pune regjistrohen pagesat për ditën paraprake. Janë identifikuar disa mangësi në regjistrimin e pagesave në sistem.

Mosbarazime në mes të dhënave të Thesarit dhe të dhënave të SITP-së. Për vitin 2017, sipas raporteve nga Thesari, të hyrat nga tatimi në pronë për periudhën Janar-Qershor ishin 10,793,134€ ndërsa për të njëjtën periudhë nga SITP të hyrat ishin: 10,218,927€ dhe pagesa të pa procesuara janë 54,440€ apo në total 10,273,367€.

Tabela 1- Diferenca e të hyrave nga tatimi në pronë në mes të sistemeve për muajt janar- qershor 2017

Thesar	ProTax Procesuara	ProTax Paprosuara	Diferenca
10,793,133€	10,218,927€	54,439€	519,766€

Gjithashtu, mosbarazime ka edhe në raportin e muajit qershor. Në raportin e ofruar nga Protax me datë 28.08.2017 ishin 2,714,370.00€ dhe 20.10.2017 ishin 3,056,424.56€.

Gjithashtu edhe komunat nuk bëjnë barazimin e raporteve të dy sistemeve. Mosbarazimet e të hyrave në mes të departamenteve, rrezikojnë që raportimi i tyre të mos jetë i drejtë.

Vonesa në regjistrimin e pagesave- zyrtari i regjistrimit të pagesave, pranon nga Thesari, çdo ditë pune pagesat për ditën paraprake. Sipas komunave ka raste kur regjistrimi i pagesave nga ana e zyrtarit në DTP, vonohet deri në 10 ditë. Gjatë auditimit ne kemi identifikuar vonesa të regjistrimit të pagesave deri në shtatë ditë. Gjithashtu, pagesat në sistem nuk janë të automatizuara. Andaj edhe mund të ndodhin gabime gjatë importimit të shkaktuara nga faktori njeri.

Pagesat e dështuara. Sipas zyrtarëve gjatë importimit të pagesave në SITP, sistemi nuk lejon të regjistrohen pagesat që përmbajnë UNIREF, datë, kohë dhe shumë të njëjta. Të gjitha këto pagesa kategorizohen si të dështuara (të pa proceduara). Gjithashtu, sistemi nuk ka pranuar pagesat e datës 30 dhe 31 dhjetor për vitet paraprake. Regjistrimi i tyre është dashur të bëhet në mënyrë manuale, nga komunat, përkatësisht nga zyrtarët e futjes së të dhënave të tatimit në pronë.

1. *Lista e pagesave të dështuara-* në listën e ofruar nga DTP, për pagesat e dështuara nga muaji korrik i vitit 2016 deri në korrik të 2017, ne kemi vërejtur që ka pagesa që janë regjistruar në sistem nga komunat.

Tabela 2 - Numri dhe vlera e pagesave të dështuara për komunat Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Graçanicë

Komunat	Nr. i pagesave	Vlera e pagesave në €
Prishtinë	880	119,470.37
Gjakovë	367	40,054.74
Pejë	274	31,789.97
Graçanicë	61	19,389.90
Gjithsej	1,582	210,704

Për regjistrimin e pagesave të dështuara, DTP nuk ka hartuar ndonjë procedurë se si duhet të regjistrohen këto pagesa. Gjithashtu, në mungesë të procedurës DTP nuk ka udhëzuar komunat me ndonjë shkresë zyrtare apo vendim, për regjistrimin e tyre, duke mos caktuar afate kohore kur duhet të bëhet regjistrimi i tyre. Si rezultat, komunat nuk përdorin praktika të njëjta për regjistrimin e tyre. Regjistrimi i tyre bëhet nga vullneti i zyrtarëve dhe koha e tyre.

Gjatë testimit të mostrave për pagesat e dështuara ne kemi vërejtur se pagesat e datës 30 dhe 31 dhjetor 2016 janë regjistruar nga komunat, mirëpo ende figurojnë si pagesa të dështuara në raportin e pagesave të dështuara. Komuna Prishtinë, Pejë dhe Graçanicës, kanë regjistruar edhe pagesat deri në muajin korrik 2017, ndërsa komuna e Gjakovës, ende nuk ka regjistruar pagesat e dështuara për vitin 2017. Zyrtari i komunës së Pejës ka identifikuar që në listën e pagesave të dështuara ka pagesa që nuk janë për tatimin në pronë, si dhe ka pagesa të dyfishta me të njëjtin UNIREF, emër, shumë dhe datë. Edhe pse kërkesa nga zyrtari komunal për fshirjen e këtyre pagesave nga lista e pagesave të dështuara është bërë në muajin prill 2017, ne kemi vërejtur se këto pagesa ende janë në listën e pagesave të dështuara, pra DTP nuk ka bërë fshirjen e tyre.

Moduli i regjistrimit të pagesave të dështuara është zhvilluar në mars të vitit 2017 duke sjellë lehtësi në regjistrimin e tyre, ku me rastin e lidhjes së pagesës këto pagesa nuk figurojnë më në listën e pagesave të dështuara. Mirëpo, pagesat e regjistruara para marsit 2017 edhe pse janë regjistruar figurojnë në listën e pagesave të dështuara. Kjo rrezikon që zyrtarët komunal të regjistrojnë disa herë këto pagesa.

2. *Regjistrimi i dyfishtë i pagesave.* Ne kemi vërejtur se ka raste kur pagesat janë regjistruar dy herë. Sipas zyrtarëve të DTP-së kjo ka ndodhur në muajin korrik dhe gusht të vitit 2016, kur Banka Qendrore e Kosovës ka ndryshuar mënyrën e raportimit dhe janë shfaqur gabime, ku pagesa e njëjtë është pranuar nga sistemi sepse kanë pasur datë të ndryshme. Sipas zyrtarëve të DTP-së këto pagesa janë fshirë nga sistemi dhe janë udhëzuar ZKTP që të bëjnë identifikimin e tyre dhe regjistrimin. Mirëpo ne nuk na është ofruar ndonjë vendim i shkruar, shkresë apo email për fshirjen e këtyre pagesave nga DTP. Në bazë të intervistave me zyrtarët komunal, jemi informuar se mungojnë pagesa të tatimpaguesve dhe regjistrimi i tyre bëhet vetëm kur tatimpaguesit paraqesin dëshmi se kanë kryer këto pagesa. Ne po ashtu kemi hasur në mostra ku tatimpaguesi i ka të regjistruara të dy pagesat që do të thotë që nuk mund të vërtetojmë se veprimi për fshirjen e pagesave ka ndodhur në të vërtet.

Shpërndarja e pagesës

Shpërndarja e pagesës ka ndryshuar kohë pas kohe, kjo për shkak se DTP nuk ka hartuar rregullore për shpërndarje të pagesës. Deri në viti 2015, shpërndarja e pagesës është bërë nga lartë –poshtë, ku me rastin e pagesës nga tatimpaguesit, fillimisht pagesa është shpërndarë për vitin aktual, ndërsa teprica e pagesës ka shkuar në vitin paraprak. Kjo shpërndaje e pagesës, nuk ka qenë në favor të qytetarëve për shkak se kur është marrë pagesa për vitin aktual, kanë vazhduar të kalkulohen kamatat dhe dënimet për vitet e kaluara.

Me faljen e borxheve, shpërndarja e pagesës ka ndryshuar konform ligjit për faljen e borxheve⁵². Ky ligj parasheh, që për të përfituar faljen e borxheve, deri në dhjetor të vitit 2008, duhet të kryhet pagesa e plotë e obligimeve për periudhën nga 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014, atëherë personat e tillë, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe me faljen e dënimit dhe interesit që rrjedh nga mos pagesa me kohë e kryegjësë së borxhit për periudhën 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014.

Kjo do të thotë që është aplikuar shpërndarja e pagesës, fillimisht duke marrë borxhin për tatim. Mirëpo, kjo mënyrë e pagesës ka vazhduar edhe pas përfundimit të faljes së borxhit. Në të gjitha mostrat kemi vërejtur se shpërndarja e pagesës aktualisht bëhet duke marrë fillimisht borxhin tatimor për të gjitha vitet, e më pas dënimin dhe kamatën.

Edhe për mënyrën aktuale të shpërndarjes së pagesës ne kemi vërejtur se vendimi është marrë nga projekti dhe zyrtarët e DTP-së nuk janë të informuar apo nuk janë këshilluar lidhur me këtë.

Kartela Financiare

Deri në muajin mars të vitit 2017, moduli financiar, përfshirë edhe kartelën financiare nuk ka qenë i automatizuar. Tatimi, kamata dhe dënimi janë llogaritur vetëm për vitin aktual, ndërsa me mbylljen e vitit për çdo ndryshim/modifikim të kamatës dhe dënimit apo regjistrimit të pagesave për vitet e kaluara është dashur që llogaritja të bëhet manualisht nga zyrtarët komunal të tatimit në pronë. Kjo mangësi ka mundur të qojë deri te llogaritja gabim e kamatave dhe dënimeve për vitet e kaluara. Gjithashtu, me korrigjimin manual edhe mundësia e keqpërdorimeve dhe gabimeve ka qenë më e madhe.

Kartela financiare është përmirësuar në mars të vitit 2017, duke kalkuluar automatikisht të gjitha tatimet, kamatat dhe dënimet edhe për vitet e kaluara. Mirëpo, edhe pse ky modul i raportimit është përmirësuar dukshëm me këtë automatizim, nga mostrat e testuara ne kemi vërejtur disa mangësi. Fillimisht, produkti i ri para lëshimit në përdorim do duhej të kalonte në të gjitha fazat e testimit. Neve nuk na janë ofruar dëshmi të testimit, me ane të cilave do të merrej vendimi për vendosjen në shfrytëzim/përdorim apo jo të këtij moduli.

Mangësitë e vërejtura lidhur me kartelën financiare janë paraqitur si në vijim:

⁵² Ligji nr.05/L-43 për faljen e borxheve publike, ligji nr.05/L-119 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.05/L-43 si dhe U.A nr.04/2015-procedurat e faljes së borxheve publike

Përmirësim Bilanci. Në 60% të mostrave të testuara, në kartelat financiare ekziston një përshkrim përmirësim bilanci, i datës 04.03.2017. Komunat, nuk kanë qenë në gjendje të shpjegojnë pse figuron ku përmirësim bilanci. Ky përmirësim bilanci ka bërë që kartelat shpeshherë të jenë konfuze dhe të paqarta.

Sipas zyrtarëve të zhvillimit të projektit, kjo ka ndodhur si pasojë e automatizimit të modulit, ku janë balancuar gjendja e kartelës së vjetër me kartelën e re.

Ne kemi analizuar këtë përmirësim bilanci në përpjekje që të qartësojmë se çka është përfshirë në shumën përmirësim bilanci. Kemi vërejtur që për të vërtetuar dhe shpjeguar shumën e përmirësimit të bilancit, nevojitet kohë e gjatë ku duhet të analizohet secili transaksion që nga viti 2008. Në përmirësim të bilancit janë të përfshira, të gjitha korrigjimet e pagesave të bërë në mënyrë manuale, korrigjimi i dënimeve dhe kamatave në mënyrë manuale, modifikimet e bëra si rezultat i ndryshimit të gjendjes nga ekzekutimi i vendimeve të bordit të ankesave, pagesat për falje të borxheve e shumë modifikime të tjera të bëra ndër vite nga ana e komunave. Për të identifikuar shumën e përmirësimit të bilancit, ka raste kur nevojitet deri në 1 ditë për një kartelë. Kjo ka kosto të lartë për komunat, dhe shpesh zyrtarët përballen me qytetarë të revoltuar nga gjendja e borxhit të tyre. Problemet më të mëdha me përmirësim bilanci kanë pasur, tatimpaguesit me falje të borxhit (falja e borxhit shtjellohet me poshtë).

Në kohën kur është bërë ndryshimi i modulit financiar, janë shfaqur fatura kontradiktore me vlera të ndryshme ku tatimpaguesit pa bërë asnjë veprim, brenda ditës apo brenda muajit në faturë ju është shfaqur gjendje e ndryshme e borxhit. Kjo sjellë dyshime që moduli është lëshuar në shfrytëzim pa u testuar në mënyrën e duhur.

Moduli i faljes së borxheve

Falja e borxhit ka ardhur si vendim i qeverisë. Projekti ka pranuar që të zhvillojë modulën e faljes së borxheve, mirëpo për shkak të kohës së shpejtë të zhvillimit të tij ky modul ka shfaqur mangësi.

Në mostrat e testuara kemi vërejtur dukuri të ndryshme të shfaqjes së pagesës. Në disa mostra pagesat për falje të borxhit nuk figurojnë te pagesat, ndërsa në disa mostra figuron si pagesë. Në rastet kur pagesa nuk figuron te pagesat, zyrtarëve ju duhet që të analizojnë transaksionet në raportin e ngjarjeve.

Ka raste kur shpërndarja e pagesës, nuk është aplikuar në vitin 2009, mirëpo ka shkuar në vitet 2008 e më parë, që nënkupton që shpërndarja nuk është aplikuar siç duhet, meqenëse tatimet, kamata dhe dënimet deri në vitin 2008 është dashur të falen. Si e tillë kjo shpërndarje ka ndikuar në mos aplikimin e faljes së borxhit për raste të caktuara edhe pse pagesat janë evidentuar. Këto raste mund të identifikohen vetëm me ankesë të tatimpaguesve.

Problemet më të mëdha janë shfaqur te tatimpaguesit me marrëveshje, ku edhe në këtë rast, shpërndarja e pagesës është bërë në mënyrë të gabuar. Në rast se këta tatimpagues dëshirojnë të bëjnë pagesë për falje të borxhit si dhe njëkohësisht të bëjnë edhe pagesën për faturat nga viti 2015,

pagesa ju shpërndahet në vitet 2009-2014, dhe kështu përpos tatimit vazhdojnë të ju kalkulohet dënimi dhe kamata për vitet pas 2015-ës.

Në këtë modul, kemi vërejtur se ka raste, ku tatimpaguesi nuk ka përfituar nga falje për 0.02€ edhe pse tatimpaguesi ka paguar borxhin sipas faturës.

Për shkak të mangësive që janë paraqitur më lartë, kartelat e tatimpaguesve me falje të borxheve janë vështirë të lexueshme dhe krijojnë paqartësi .

Raportet

Sipas manualit të përdorimit të sistemit , ekzistojnë disa lloje të raporteve: raporti i ngarkesës dhe inkasimit sipas periudhës kalendarike, gjenerimi i listës së pronave për komuna si dhe raporti i progresit.

Raporti i ngarkesës dhe inkasimit sipas periudhës kalendarike

Komunat vazhdimisht kanë hasur problem me modulën e raportimit. Raporti nuk pasqyron gjendjen e njëjtë për periudhën e njëjtë. Kjo për shkak se në modulën e raportimit nuk ka ekzistuar një " raport historik"⁵³ i cili do të tregonte një saldo përfundimtare për vitin fiskal. Këto mangësi janë cekur edhe nga raportet e auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitet e kaluara. Nëse kërkohet një raport për të hyrat nga tatimi në pronë, kamata dhe dënimet për vitin e kaluar 1 janar-31 dhjetor 2016, raporti asnjëherë nuk del i njëjtë. Kjo për shkak se në këtë raport integrohen edhe pagesat e bëra në vitin aktual për vitin e kaluar. Pra, nuk mund të dihet gjendja e saktë sa ka qenë për vitin e kaluar. Ky raport do t'i ndihmonte komunave në analiza më të hollësishme lidhur me ndryshimet që janë bërë lidhur me pagesat si dhe llogaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë. Si pasojë e kësaj, komunat asnjëherë nuk bazohen në raportet e dala nga sistemi i tatimit në pronë për të hyrat dhe të arkëtueshmet për tatimin në pronë. Kjo mund të ndikojë edhe në raportimin e drejtë të komunave për këta zëra të Pasqyrave Financiare.

Gjatë kohës kur ishim në auditim, komunat nuk kanë mundur të na ofrojnë raporte për gjendjen e tatimit në pronë. Kjo për shkak të zhvillimeve dhe ndryshimeve të vazhdueshme në sistem. Aktualisht komunat nuk bazohen në raportet e sistemit⁵⁴, të cilat sipas tyre nuk janë të sakta.

Raportet nuk janë të qasshme për komuna. Gjatë vitit 2017, komunat kanë pasur vështirësi të mëdha në gjenerimin e raporteve. Prandaj, DTP ka vendosur që të gjitha raportet që komunat dëshirojnë ti kenë, ti marrin përmes kërkesës në DTP. DTP, në këtë rast ka marrë kompetencën e komunave për raportim, pa ndonjë vendim të shkruar. Për më shumë, ekipi i projektit ka marrë vendim për ndërprerjen e modulit të raportimit. . Ndërsa, zyrtarët e DTP-së janë njoftuar vetëm verbalisht për këtë ndërprerje pa ndonjë shkresë dhe arsyetim nga ana e projektit për këtë ndërprerje.

⁵³Me raport historik kemi nënkuptuar raport që paraqet gjendjen e njëjtë për periudhën e njëjtë, pa marrë parasysh ndryshimet e mëvonshme si p.sh pagesat që rezultojnë në ndryshim të gjendjes së asaj periudhe

⁵⁴ Për paraqitjen e të hyrave nga tatimi në pronë në PVF, komunat paraqesin të dhënat nga SIMFK, mirëpo për llogaritë e arkëtueshme të dhënat mirën nga sistemi ProTax.

Moduli i raportimit është duke u përmirësuar dhe ky raport i ngarkesës mund të ndahet sipas vitit kalendarik, andaj për shkak se ky funksion është në zhvillim e sipër, gjatë kësaj faze të auditimit nuk kemi verifikuar plotësinë dhe saktësinë e tyre.

Raporti i Progresit, raporti i pronave dhe raporti i ngjarjeve

Raporti i progresit të inkasimit⁵⁵ aktualisht nuk është në funksion. Zyrtarët e projektit, kanë deklaruar që tani raporti i modifikuar i ngarkesës dhe inkasimit e përfshinë edhe këtë raport.

Gjatë kohës së auditimit edhe raporti i pronave⁵⁶ nuk ishte në dispozicion për komunat. Ndërsa, raporti i ngjarjeve edhe pse ishte në dispozicion gjatë testimit ne kemi vërejtur se ky raport ⁵⁷ nuk është i saktë. (gjurmueshmëria trajtohet gjerësisht më poshtë).

3.2.3 Siguria e aplikacionit

Siguria e aplikacionit ka të bëjë me ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së informacionit në elementet e aplikacionit.

Për sigurinë e aplikacionit është vlerësuar nëse informacioni i aplikacionit është i sigurt kundrejt keqpërdorimeve. Për të arritur këtë DTP duhet të krijohet kontrolle. Kontrollat duhet të jenë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive për të siguruar që gjurmët e auditimit gjenerohen dhe mirëmbahen për të gjitha të dhënat e transaksioneve.

Gjurmueshmëria e transaksioneve

Gjatë testimit të raporteve të ngjarjeve, kemi vërejtur se ka raste kur ky raport nuk është i saktë dhe nuk përshkruan të gjitha transaksionet. Në një rast në Prishtinë, kemi vërejtur se zyrtarja ka modifikuar vetëm adresën e një prone mirëpo në raportin e ngjarjeve figurojnë sikur ka modifikuar edhe m2 të asaj prone. Njëjete ka ndodhur edhe në raportin e ngjarjeve të marrë në Gjakovë. Po ashtu është vërejtur që me modifikimin e një prone, gjendja e saj është shënuar si prone e re, ne vend se ajo të shënohet si e modifikuar. Ekipi i zhvillimit të projektit, ka konfirmuar se ekziston një gabim, të cilit i janë referuar si "BUG"⁵⁸, në të cilin vetëm se është duke u punuar, mirëpo ne nuk na është ofruar dëshmi. Gjithashtu, DTP nuk ka një listë të këtyre gabimeve-BUG të sistemit.

Kjo e vështirëson gjurmueshmërinë dhe vërteton se nuk ka gjurmueshmëri të veprimeve. Mungesa e raportit të saktë të ngjarjeve rrit rrezikun që gabimet e qëllimshme apo rastësishme të mos mund të identifikohen.

⁵⁵ Raporti të inkasimit gjenerohet për vitin aktual; sipas vendit, rrugës etj.

⁵⁶ Raporti i listës së pronave përmban të dhënat për të gjitha pronat e komunës përkatëse.

⁵⁷ Raporti i ngjarjeve paraqitet si raport sipas llojit të ngjarjes apo shfrytëzuesit të sistemit. Poashtu ky raport mund të filtrohet sipas dates nga data e fillimit deri te data e mbarimit.

⁵⁸ Gabim ose lëshim i identifikuar, i cili pengon ne operimin e mirëfillte të sistemit

Gjurmueshmëria e bazës së të dhënave

Në bazën e të dhënave të sistemit ProTax, gjatë auditimit kemi kërkuar që të na japin raportin e gjurmueshmërisë së ngjarjeve në bazën e të dhënave. Mirëpo, sipas zyrtarëve të projektit, nuk mund të gjenerohet diçka te tillë.

Qasja logjike

Në rastet kur bëhet hapja e llogarisë së shfrytëzuesit dhe i mundësohet qasja, por edhe me rastin e ndryshimit të fjalëkalimit, kredencialet dërgohen me e-mail nga administratori i sistemit. Shfrytëzuesi nuk është i obliguar të ndryshoj fjalëkalimin pas qasjes së parë. Zbatimi i kompleksitetit të fjalëkalimit në sistem nuk ekziston si dhe sistemi nuk ka histori të fjalëkalimeve. Në raste të tentimit të pasuksesshëm të qasjes në sistem më shumë se tri here, qasja e shfrytëzuesit nuk pezullohet dhe si të tilla nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme të qasjes logjike në sistem. Kjo ka ndodhur si pasoje e mungesës së procedurave për menaxhimin e shfrytëzuesve dhe fjalëkalimit.

Në listën e dërguar të shfrytëzuesve të cilët kanë autorizim për qasjen në aplikacion kemi raste ku një zyrtar/shfrytëzues me emër dhe mbiemër të njëjtë janë aktiv me dy llogari/ID (user) të ndryshëm. Po ashtu, janë disa shfrytëzues aktiv që për herë të fundit janë qasur në sistem në vitin 2016 dhe llogaritë e tyre nuk janë pasivizuar. Verifikimi i shfrytëzuesve bëhet në fund të çdo viti ku kërkohet nga secila komunë që të dërgoj listën e shfrytëzuesve, por nuk na është dëshmuar kjo procedurë apo praktikë.

Po ashtu, kemi gjetur se shfrytëzuesit e privilegjuar, me qasje administrative në sistem shfrytëzojnë llogari/ID të emërtuara me përmbajtje në emër administrator (p.sh. administratori-tax, tatimi_administratori, etj⁵⁹), mirëpo është e pamundur ndërlidhja e shfrytëzuesit i cili qaset me këto llogari/ID pasi që këto mund të përdoren nga më shumë se një shfrytëzues.

Gjurmueshmëria e qasjes në sistem për shfrytëzuesit e sistemit nuk është e plotë. Nuk na është ofruar dëshmi se kur është bërë ndryshimi i fundit i fjalëkalimit, privilegjeve të tij, apo edhe aktivizimi dhe pasivizimi i llogarive/ID. Sistemi e ofron informatën vetëm kur është kyçur shfrytëzuesi herën e fundit në sistem.

Në ofrimin shtesë të sigurisë së përdorimit të aplikacionit, mund të kontribuojnë edhe zyrtarët e TI-së në komuna. Në të gjitha komunat e audituara kemi vërejtur se disa shfrytëzues të sistemit në ZKTP, kanë privilegj të administratorit, në kompjuterët e shfrytëzuar për qasje në SITP. Kjo e drejtë ju mundëson instalimin e programeve të paautorizuara nga personat e paautorizuar që mund të ndikojnë në keqpërdorimin e sistemit.

⁵⁹ Për shkaqe të sigurisë nuk kemi listuar emërtimet e sakta të shfrytëzuara në sistem

3.3 Efektiviteti i menaxhimit të shërbimeve

3.3.1 Kërkesat e përdoruesve të sistemit

Reagimi i shpejtë dhe efektiv ndaj kërkesave të përdoruesve në ofrimin e shërbimeve të përkrahjes së shfrytëzuesve, duhet që fillimisht të jetë i mbështetur me politika, procedura apo rregullore të punës⁶⁰. Kjo arrihet duke ofruar një tavolinë ndihmëse të dizajnuar dhe zbatuar mirë, si dhe një proces të menaxhimit të incidenteve.

Në mungesë të akteve rregullative për këtë fushë, ne kemi zhvilluar intervista me personat përgjegjës për ofrimin e përkrahjes së shfrytëzuesve si dhe kemi vëzhguar punën e tyre për të vlerësuar efektivitetin e këtij shërbimi. Mangësitë janë paraqitur në vijim:

- Menaxhimi i incidenteve dhe Tavolinës Ndihmëse(TN) - në mungesë të personelit të dedikuar nga MF- DTP, projekti ka angazhuar një person për këtë detyrë. Mirëpo i tërë personeli i projektit, është përfshirë në ofrimin e përkrahjes së shfrytëzuesve, pasi që udhëzimet e ndryshme të shfaqura në sistem, referonin shfrytëzuesit që të kontaktonin persona të ndryshëm, duke përfshirë numrat e tyre të telefonit dhe emailat e tyre në disa raste edhe privat e jo emailat zyrtar apo një email adrese të vetme.
- Për menaxhimin e kërkesave dhe përshkallëzimin e incidenteve, janë përdorur praktikatat duke u bazuar në vendime të momentit duke mos i adresuar ato çdo herë në vendin e duhur dhe duke shkaktuar vonesa në realizimin e tyre, e gjithë kjo ka rrjedh si pasojë e mungesës së procedurave.
- Për mbylljen e incidenteve apo realizimin e kërkesave të shfrytëzuesve, nuk ekzistojnë njohuri për hapat e ndërmarrë për të zgjidhur rastet. Veprimet e ndërmarra janë bërë sipas kërkesës së shfrytëzuesit pasi që nuk kishte procedura për këtë çështje.
- Po ashtu mungojnë shënimet për rastet e pa zgjidhura, të cilave shpesh herë u janë referuar vetëm si "BUG", mirëpo duke mos i dokumentuar ato në mënyrën e duhur.
- Gjenerimi i informatave apo prodhimi i raporteve rreth numrit apo kategorive të rasteve të paraqitura ka munguar.
- Gjithashtu ka munguar regjistrimi dhe identifikimi i rasteve të paraqitura nga shfrytëzuesit, si dhe kanë munguar mekanizmat për të matur kohën e realizimit të kërkesave të shfrytëzuesve.

Në takimin e fundit të mbajtur në DTP, jemi njoftuar se vetëm janë ndërmarrë masa rreth kësaj çështje dhe se kanë instaluar një aplikacion softuerik për regjistrimin, përcjelljen dhe përshkallëzimin e rasteve të paraqitura nga shfrytëzuesit, veprim ky i cili mund të konsiderohet si masë pozitiv drejt përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për shfrytëzuesit.

⁶⁰ Manuali i auditimeve të TI-së, për Institucionet Supreme të Auditimit

3.3.2 Matja e performancës së sistemit, vendosja e kufijve kritik për matje dhe krahasim të rezultateve

DMSTI në bashkëpunim me DTP-në, me anë të marrëveshjes në nivel operacional, duhet të bëjë mbikëqyrjen e përditshme të performancës së sistemit, duke përcaktuar kufijtë kritik për matjet dhe pritjet nga sistemi. Mungesa e procedurave për realizimin e matjes së performancës së resurseve të TI-së ka ndikuar në mos ofrimin e një shërbim efektiv të SITP-së.

Gjatë testimeve të bëra, ne kemi vërejtur se për një periudhe të caktuar kohore, disa shërbime si p.sh. raportet janë ndërprerë për arsye të mungesës së kapaciteteve harduerike për operimin e mirëfillte të SITP-së. Këto kapacitete janë vendosur jashtë shërbimit me arsyetimin se MF-DMSTI është duke realizuar përditësimin e sistemeve operative, mirëpo përgjatë kësaj periudhe nuk janë gjetur zëvendësime për vendosje të përkohshme të sistemit, në mënyre që mos të ndërpritet funksionimi i mirëfillte i tij. Po ashtu DTP ka kërkuar furnizime me pajisje harduerike shtesë nga MF, mirëpo e njëjta ka dështuar në sigurimin e tyre.

3.3.3 Mekanizmat për menaxhimin e ndryshimit

Procesi i menaxhimit të ndryshimit përdoret për të menaxhuar dhe kontrolluar ndryshimet ndaj asetëve apo programeve. Sipas praktikave të mira për menaxhimin e ndryshimit, procesi i menaxhimit të ndryshimit duhet të sigurojë që ndryshimet janë regjistruar, vlerësuar, autorizuar, prioritarizuar, planifikuar, testuar, implementuar, dokumentuar dhe rishikuar në përputhje me procedurat e dokumentuara dhe të aprovuara të menaxhimit të ndryshimit.

Kohëve të fundit janë zbatuar ndryshime në SITP, mirëpo këto ndryshime nuk janë zbatuar sipas praktikave të mira për menaxhimin e ndryshimeve.

Për përcaktimin e detajuar të proceseve, projekti fillimisht është mbështetur në të ashtuquajturat "UseCase" në bazë të të cilave është ndërtuar SITP. Mirëpo gjatë kohës janë bërë ndryshime në SITP dhe nuk është dokumentuar asnjë ndryshim apo është përcjelle procedura e duhur e aprovimit. Po ashtu janë zhvilluar funksione shtesë, të cilat janë identifikuar si të nevojshme gjatë kohës, mirëpo as për këto nuk është dokumentuar procesi apo janë përcjelle procedurat e duhura të aprovimit për vendosjen e tyre.

E njëjta praktike është përcjelle edhe për modulën e faljes së borxheve, duke mos dokumentuar në tërësi procesin, testuar atë, si dhe se fundi duke mos miratuar vendosjen e tij në SITP. Kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së politikave dhe procedurave për menaxhimin e ndryshimeve, nga njësia përgjegjëse brenda MF-së, përkatësisht DTP.

3.3.4 Ruajtja e të dhënave në kopje rezervë

MF, përkatësisht DMSTI duhet të posedojë procedura për ruajtje të kopjes së të dhënave. Këto të dhëna duhet të testohen për mundësinë e rikthimit të tyre, si dhe të aftësohet personeli i dedikuar për vazhdimësi të punës. Fillimisht, duhet theksuar se DMSTI ka hartuar një procedure për ruajtjen e kopjeve të të dhënave dhe rikthimin e tyre, mirëpo nuk ka arritur të dëshmojë se kjo procedure është e miratuar nga udhëheqësit e këtij institucioni dhe si e tillë nuk detyron palët e përfshira në zbatimin e saj në plotësi. Aktualisht, ruajtja e të dhënave në kopje bëhet nga ekipi i zhvillimit të projektit.

4 Konkluzionet

MF nuk ka arritur të sigurojë një mjedis efektiv të kontrollit për të siguruar funksionim e mirëfillte të SITP-së. MF nuk ka arritur të përmbush kushtet e marrëveshjes për projektin lidhur me zhvillimin e SITP-se. Si i tillë ky sistem ka rezultuar të mos jetë plotësisht efektiv. Në mos efektivitetin e këtij sistemi kanë ndikuar edhe mangësitë në qeverisjen dhe menaxhimin e mirëfillte të TI-së në MF. Për më shumë, DTP nuk ka arritur që të vendos plotësisht kontrollet për të dhënat hyrëse, të dhënat dalëse si dhe sigurinë e aplikacionit. Mungesa e tyre mund të ndikoj në besueshmërinë e sistemit. Po ashtu, ofrimi i shërbimeve ndaj zyrtarëve përgjegjës në komuna nuk ishte efektiv, kjo ka ndikuar në performancën dhe shfrytëzimin jo efektiv të SITP-së nga shfrytëzuesit. Nëse mangësitë e vërejtura nuk eliminohen, mund të vihet në pikëpyetje qëndrueshmëria e sistemit.

Strategjia, Politikat, procedurat e TI-së dhe skema organizative

MF, nuk ka hartuar strategjinë e TI-së, dhe në mungesë të saj rrezikohet që sistemet brenda MF-së siç është edhe SITP-së të mos funksionojnë të centralizuara si dhe objektivat e institucionit të mos mund të përkthehen në funksionet e nevojshëm të TI-së.

MF nuk ka hartuar politika dhe procedura të TI-së si dhe struktura organizative nuk ka gjetur zbatim. Nga mungesa e politikave dhe procedurave ekziston rreziku për cilësinë e TI-së, sigurisë së informacionit, si dhe zotërimit të dhënave. Ndërsa, mungesa e personave përgjegjës në DMSTI për shumë pozita, ndikon direkt në mos ofrimin e përkrahjes për SITP-në si dhe mund të rrezikojë sigurinë dhe besueshmërinë e sistemit.

Shtrirja e sistemit të tatimit në pronë

SITP nuk është i shtrirë në të gjitha komunat e Kosovës. Shkak për këtë është mungesa e vullnetit nga këto komuna për të mbledhur të hyra nga tatimi në pronë. Mos mbledhja e të hyrave nga tatimi në pronë, ndikon drejtpërsëdrejti në performancën e komunës dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Zhvillimi i projektit, strukturat udhëheqëse dhe mbikëqyrja e projektit

MF nuk ka arritur të plotësoj kushtet e parapara në marrëveshjen për zhvillimin e projektit. Si rrjedhojë e kësaj, zbatimit i projektit është përcjellë me kufizime siç janë: miratimin e legjislacionit për tatim, angazhimin e personelit dhe të plotësojë nevojat për operim dhe mirëmbajtje të sistemit duke përfshirë edhe infrastrukturën e nevojshme.

Në rast se MF, nuk ndërmerr hapa konkret në plotësimin e kushteve, ekziston rreziku që përkrahja nga projekti të ndërpritet. Meqenëse nuk është paraparë së çfarë do të ndodhë në rast të ndërprerjes së mëhershme të marrëveshjes, si rezultat i mosplotësimit të kushteve të dakorduara, ekziston rreziku që marrëveshja të ndërpritet dhe funksionim i SITP-së të vihet në pikëpyetje. Nëse marrëveshja ndërpritet do të ketë një kosto të lartë për MF-në dhe si rrjedhojë do të pësonin edhe përfituesit e SITP, përkatësisht komunat dhe qytetarët.

Komiteti drejtues i cili e ka rolin e organit mbikëqyrës të projektit është takuar rrallë dhe nuk i ka adresuar me kohë dhe si duhet çështjet e dala gjatë zbatimit të projektit. Çështjet e mos adresuara me kohe nga komiteti drejtues, kanë ndikuar në shtyrjen e zhvillimit dhe zbatimit të sistemit në tërësi.

Identifikimi i kërkesave për ndryshime

DTP nuk ka hartuar procedura për identifikimin dhe ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për ndryshim të kërkesave. Asnjë zyrtar i DTP- së nuk merr pjesë në takimet e ekipit të projektit, ku edhe shqyrtohen kërkesat e shfrytëzuesve. Kjo ka sjellë paqartësi se kush duhet të merr vendime lidhur me kërkesat e reja. Andaj ekziston rreziku që mos të merren vendimet e duhura në kohën e duhur dhe DTP të mos jetë e informuar për vendimet.

Komiteti drejtues nuk ka nxjerre vendime të shkruara për çështje të caktuara lidhur me ecurinë e projektit apo kërkesave të tjera. Si të tilla vendimet nuk kanë efekt, prandaj ekziston rreziku që këto vendime të dakorduara gjatë takimeve të mos zbatohen fare.

Të dhënat hyrëse - Vlefshmëria e të dhënave

Sistemi nuk posedon mekanizmat apo mjetet e duhura për të identifikuar apo trajtuar vendosjen e të dhënave jo të vlefshme. Pronat nuk kanë mundësi të identifikimit nga ortofoto në pajisjet mobile, si dhe nuk aplikohet funksioni i detyrueshëm për identifikimin e taksapaguesit dhe objektit nëse është regjistruar në sistem, kjo rrezikon regjistrim e dyfishtë të tyre. Po ashtu kemi konstatuar mangësi në regjistrimin masiv të pagesave në sistem ku rreziku është që pagesat të jenë regjistruar më shumë se një herë.

Sistemi nuk ka aplikuar rregulla të vlefshmërisë në pajtim me aktet rregullative, në rastin e cilësisë së ndërtimit nuk është aplikuar cilësia si bazë për tatim. Ndërsa për banim, aplikohet zbritja prej 10,000 euro, për të gjitha pronat pavarësisht nga numri i pronave që ka tatimpaguesi. Mungesa e vlefshmërisë në pajtim me aktet nënligjore ka ndikim financiar, ku në disa raste shkon në dëm të Komunës dhe në përfitim të tatimpaguesve dhe anasjelltas.

Ndërsa, mos përditësimi i manualit, ndikon në mospërdorimin efektiv të sistemit nga shfrytëzuesit e ri të sistemit.

Trajtimi i gabimeve

DTP nuk ka hartuar politika dhe procedura për trajtimin e të dhënave të refuzuara, ku përmes saj përcaktohen se si SITP do të trajton gabimet apo refuzimet e transaksioneve dhe mënyra se si do të trajtohen ato në rastet e përshkallëzimit të tyre. Nga mungesë të tyre dhe procedurave për rishikimin e dosjeve në pezullim, ekziston rreziku që gabimet e njëjta të ndodhin disa herë dhe të mos trajtohen në mënyrën e duhur.

Klasifikimi i llojit të gabimeve që ndodhin gjatë transaksioneve nuk bëhet, andaj identifikimi i tyre nuk ka mundësi të bëhet dhe ka rrezik që këto gabime të përsëriten dhe si të tilla vështirësojnë apo

pamundësojnë punën e shfrytëzuesve. Po ashtu DTP nuk ka vendosur një pikë të vetme zyrtare kontakti për kontaktim dhe paraqitje të gabimeve, kjo shkakton konfuzion tek shfrytëzuesit, por edhe pamundëson përcjelljen e realizimit të tyre.

Autorizimi i vendosjes së të dhënave

SITP nuk ofron siguri të mjaftueshme të qasjes logjike për shfrytëzuesit, për shkak të mungesës së procedurave për menaxhimin dhe autorizimin e shfrytëzuesve, si dhe kontrollit të dobët të vërtetimit të identitetit. Kjo mund të rezultojë në qasjen e paautorizuar në SITP dhe si të tilla cenon sigurinë e sistemit. Rishikimet e të drejtave të qasjes nuk realizohen në baza të rregullta periodike dhe ekziston rreziku që të drejtat e tepruara apo qasjet e pa autorizuara të mos zbulohen.

Plotësia dhe saktësia e të dhënave dalëse

Të dhënat në dalje kanë shumë mangësi, nuk ka procedura për të siguruar se plotësia dhe saktësia e të dhënave dalëse është vlerësuar dhe ato mund të përpunohen apo procedohen me tutje. Mungon gjurmimi i tyre. Kontrollat e plotësisë dhe saktësisë nuk janë efektive.

Pagesat, mosbarazimi i pagesave, vonesat në regjistrimin e tyre dhe pagesat e dështuara

Ne kemi konstatuar mos barazimet në mes të sistemit ProTax dhe SIMFK-së, dhe si pasojë paraqet rrezikun që qytetarëve që kanë paguar obligimin mos t'u zbritet kjo shumë e paguar në sistemin e Protax-it, dhe të ngarkohen përsëri me obligimin e paguar. Komunat nuk bëjnë barazimin e raporteve në mes të dy sistemeve, andaj rrezikojnë që raportimi i tyre të mos jetë i drejtë. Po ashtu kemi konstatuar vonesat në regjistrimin e pagesave dhe mos fshirjen e pagesave të dështuara nga lista e pagesave të dështuara pas regjistrimit të tyre, gjë që mund të rrezikoj që ato të regjistrohen më shumë se një herë dhe mos të kemi pasqyrimin e drejtë dhe të plotë të pagesave në sistem për shkak të vonesave të regjistrimit.

Shpërndarja e pagesës

Në mungesë të rregullores për shpërndarjen e pagesës, shpërndarja ka ndryshuar disa herë. Fillimisht, është aplikuar nga lartë-poshtë, pastaj me hyrjen në fuqi të ligjit për faljen e borxheve, shpërndarja ka ndryshuar në poshtë-larte. Ky ndryshim aplikohet vetëm për fushëveprimin i cili e mbulon periudhën e faljes së borxheve, e jo edhe shpërndarjen e pagesave jashtë këtij fushëveprimi.

Shpërndarja e ndryshme e pagesës ka sjellë vështirësi edhe në leximin e kartelave financiare si dhe ka sjellë pakënaqësi të mëdha të tatimpaguesit.

Kartela e re financiare

Kjo kartel është zbatuar pa realizuar testimin e mirëfillte dhe dokumentimin e saj. Po ashtu nuk janë dokumentuar përkufizimet për llogaritjet e realizuara. Vonesat në azhurnimin e kartelës financiare dhe faturës shkaktojnë paqartësi dhe mungesë të lidhjes në të dhënat e paraqitura.

Moduli për faljen e borxheve

Ky modul është përcjelle me shumë mangësi, në shfaqjen e pagesës, shpërndarja e saj si dhe problemet më të mëdha janë paraqitur në rastet kur tatimpaguesit edhe kanë bërë pagesë për falje edhe kanë bërë pagesë të faturave të rregullta. Të gjitha këto mangësi mund të ndikojnë në paraqitjen jo të drejtë të gjendjes së këtyre tatimpaguesve në kartelat e tyre.

Shërbimet e ndryshme në sistem, si ai i raportimit që përmban në vete nën funksione të ndryshme, nuk ka realizuar në tërësi qëllimin e tij. Shpesh herë janë paraqitur paqartësi në të dhënat e paraqitura, vështirësi në përpilimin e raporteve e deri tek ndërprerja e funksionimit të këtij shërbimi duke mos njoftuar apo marr aprovimin e duhur nga menaxhmenti i DTP-së.

Për të dhënat dalëse, mund të konkludojmë se funksionet dhe module të reja janë zbatuar në sistem duke mos ndjekur praktikën e mira të zgjerimit të sistemit. Ato janë vendosur duke mos u dokumentuar, testuar, miratuara si dhe janë zbatuar në bazë të momentit. Mangësitë në të dhëna dalëse kanë efekt negativ në saktësinë dhe plotësinë e të dhënave.

Siguria e aplikacionit

Sistemi nuk ofron gjurmueshmëri të plotë. Mungesa e plotësisë së saj për të gjitha veprimet e realizuara në sistem nga hapja e deri te mbyllja e tyre, mund të ndikojnë në realizimin e paautorizuar të veprimeve dhe keqpërdorimit të të dhënave në sistem duke mos identifikuar saktë realizuesit të veprimit dhe të kohës. Kjo gjithashtu ndikon në pamundësinë e matjes së performancës së shfrytëzuesve. Ndërsa, mungesa e gjurmueshmërisë në bazën e të dhënave mund të shkaktojë rrezik në keqpërdorimit të të dhënave duke mos e identifikuar se nga kush është bërë një ndryshim, shtim apo fshirje e të dhënave, procedurave apo funksioneve të caktuara brenda bazës së të dhënave dhe menaxhimit të tyre. Mos menaxhimi i qasjes së të drejtave të shfrytëzuesve nga komunat dhe mos kontrolli i dhënies së privilegjeve në pajisjet e shfrytëzuara për qasje në sistem nga komunat, rrezikon në keqpërdorimit të sistemit.

Menaxhimi i kërkesave të përdoruesve

Në mungesë të hartimit të procedurave për operimin e tavolinës ndihmese, mënyrës së paraqitjes së rasteve nga shfrytëzuesit, qofshin ato incidente, probleme, apo kërkesa të tjera për ndihmë rreth shfrytëzimit të sistemit, si dhe monitorimit të trajtimit të këtyre rasteve DTP nuk ka arritur që ofroj përkrahjen e duhur dhe në kohë, për të gjithë shfrytëzuesit. Kjo ka ndikuar në rritjen e kohës joproduktive të shfrytëzuesve, pakënaqësinë e shfrytëzuesve, si dhe mos trajtimin apo adresimin e problemeve të cilat përsëriten. Po ashtu, është vlerësuar se nuk janë përcjell dhe kategorizuar të gjitha kërkesat e paraqitura nga shfrytëzuesit dhe kjo ka ndikuar edhe në mos trajtimin e tyre në kohën e duhur apo mënyrën e përshtatshme.

Matja e performancës së sistemit

Për shkak të monitorimit jo të duhur të performancës, është i pamundur planifikimi i kapaciteteve të nevojshme për funksionim të mirëfillte në rast të dështimit të operimit të pajisjeve të TI-së. Po

ashtu kjo pamundëson planifikimet e kapaciteteve të nevojshme për operimin e duhur në të ardhmen.

Menaxhimi i ndryshimeve

Ndryshimet e zbatuara në SITP nuk janë dokumentuar në mënyrën e duhur dhe si të tilla pamundësojnë përcjelljen e ndryshimeve të bëra, po ashtu, ndryshimet emergjente të cilat mund të rezultojnë si të nevojshme, apo edhe rikthim në gjendjen paraprake nuk janë të përcaktuara. Mungon edhe dokumentimi i procesit të autorizimit për ndryshimet e bëra dhe si i tillë pamundëson llogaridhënien e duhur, apo edhe rrit mundësinë e realizimit të këtyre ndryshimeve të pa autorizuara.

Ruajtja e të dhënave rezervë

Në mungese të ndonjë procedure apo rregullore të miratuar nga DMSTI, e cila përkufizon: palët përgjegjës, periudhat, llojin, vend ndodhjen, testimin, rikthimin e të dhënave nga kopjet rezerve. DTP nuk ka realizuar këto aktivitete përveç krijimit të kopjes rezerve në lokacionin primare të ruajtjes së tyre. Ekziston rreziku që në rast të nevojës, nuk mund të sigurohet rikthimi i plotë i sistemit apo të dhënave nga kopjet rezerve. Po ashtu nuk dihet koha e duhur për rikthimin e tyre si dhe palëve përgjegjës për realizimin e këtij aktiviteti.

5 Rekomandimet

Rekomandimet e dhëna kanë për qëllim që përmirësojnë mjedisin e kontrollit në mes të strukturave udhëheqëse dhe proceseve institucionale për të siguruar funksionimin e SITP-së, përkatësisht zbatimin dhe mbarëvajtjen e këtij sistemi, si dhe ofrimin e informatave të besueshme, tërësishme dhe në kohën e duhur. Në mënyrë që kjo të arrihet rekomandimet do të ndahen sipas palëve përgjegjës për adresimin e tyre. Duhet theksuar se për hartimin e politikave dhe procedurave të nevojshme për SITP-në, DTP duhet të përkrahët nga DMSTI si dhe nga ekipi i projektit.

Rekomandojmë Ministrinë e Financave që të:

- Sigurohet që departamentet brenda MF- së kanë resurset e nevojshme për funksionim;
- Sigurohet që janë duke u përmbushur zotimet e bëra me marrëveshje për plotësimin e personelit, sigurimin e infrastrukturës si dhe zotimet e tjera të marrëveshjeve të realizuar në mes të MF-së , ATS-së dhe MF-së me SIDA-ën.
- Zhvilloj strategji dhe plane për përfshirjen e katër komunave për mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë si dhe shfrytëzimin e sistemit për menaxhimin e të dhënave të tatimit në pronë.

Rekomandojmë Komitetin drejtues që të:

- Adresoj më tutje përmbushjen e marrëveshjes si dhe të sigurohet se plani i projektit është duke u zbatuar siç është paraparë. Gjithashtu, të formalizoj vendimet e ndërmarra në takime duke caktuar personat përgjegjës dhe afate kohore për zbatimin e tyre, si dhe të monitorojë afatet kohore të projektit dhe të kërkojë llogari për moskryerjen e tyre.

Rekomandojmë MF, përkatësisht Departamentin për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë Informative që të:

- Hartoj planin strategjik të Teknologjisë Informative, duke adresuar qartë objektivat e institucionit në operacione e TI-së. Ky plan duhet së paku të mbulojë buxhetin e investimeve/operacioneve, burimet financuese, burimet e strategjisë, kërkesat ligjore dhe rregullative;
- Hartoj politika dhe procedura të TI-së, përfshirë këtu edhe politikat dhe procedurat e nevojshme për nevojat e SITP-së;

Rekomandojmë MF, përkatësisht DTP në bashkëpunim me ekipin e projektit që të:

- Hartoj politika dhe procedura për identifikimin e kërkesave, duke përfshirë edhe priorizimin dhe monitorimin e tyre për të siguruar se ato janë duke u kryer në përputhje me kërkesat e shfrytëzuesve/përdoruesve, ndërsa për kërkesat që nevojitet aprovim të paraqiten të KD për aprovim. Njëkohësisht, duhet të përfshihet në të gjitha takimet e ekipit të projektit për të siguruar informata të mjaftueshme për këto kërkesa.

-
- **Sigurohet që të krijohë kontrole efektive të aplikacionit, duke hartuar politika dhe procedura të përshtatshme si dhe duke krijuar mekanizma të kontrollit për të verifikuar zbatimin e tyre si dhe të mundësohet gjurmimi i tyre duke:**
 1. Krijuar rregulla të vlefshmërisë për të dhënat hyrëse dhe procesimin e tyre: duke krijuar mekanizma identifikues për eliminimin e regjistrimeve të dyfishta në sistem; duke mundësuar në sistem dhe në pajisjet mobile identifikimin e pronave dhe taksapaguesve të regjistruar dhe atyre të paregjistruara;
 2. Duhet të mundësohet regjistrimi automatik i pagesave në sistem, përfshirë këtu edhe pagesat e datës 30 dhe 31 dhjetor;
 3. Të aplikohet rregulla të vlefshmërisë konform ligjit dhe rregulloreve; sidomos duhet të krijohë mekanizma për identifikim e tatimpaguesit që ka më shumë se një pronë për banim si dhe të aplikohet cilësia në llogaritjen e bazës tatimore;
 4. Të përditësojë manualin e përdorimit të sistemit për secilin modifikim apo funksion shtesë në SITP;
 5. Hartojë procedura për trajtimin e të dhënave të refuzuara, ku duhet të paraqiten qartë objektivat për trajtimin dhe komunikimin e gabimeve apo refuzimeve të transaksioneve në sistem dhe mënyrën se si duhet të ndërmerren hapat e duhur për trajtimin e tyre;
 6. Hartoj procedurat për aprovimin, pezullimin apo refuzimin e autorizimit të e shfrytëzuesve, ku duhet të paraqiten qartë mënyra e hapjes, ndryshimit dhe mbylljes së shfrytëzuesit. Në rastet e pamundësisë së ndarjes së përgjegjësive të siguroj kontrole kompozuese mbi shfrytëzuesin. Kjo procedurë po ashtu duhet të përmbajë përkufizimet për përmirësimin e sigurisë së menaxhimit të fjalëkalimeve dhe të përfshijë në vete kompleksitetin dhe periudhat kohore për ndryshim;
 7. Të përkufizohet numri i tentimeve të pasuksesshme para pezullimit të shfrytëzuesit, të mundësohet gjurmueshmëria e qasjes si dhe të hartohen procedura për mundësimin e qasjes pas pezullimit; dhe
 8. Të bëhet rishikimi në baza të rregullta, periodike i roleve dhe përgjegjësive të shfrytëzuesit.
 - **Sigurohet që të dhënat dalëse të jenë të plota dhe të sakta duke:**
 1. Hartuar procedurë për regjistrimin e pagesave, duke përfshirë importimin e të dhënave nga Thesari, mekanizmat për identifikim dhe trajtim të pagesave me gabim apo të dyfishta, caktimin e afateve kohore për verifikimin dhe importimin e tyre në SITP, si dhe njoftimin e zyrtareve komunal për klasifikim e pagesave për trajtim të mëtutjeshëm nga ta;
 2. Të bëjë regjistrimin e pagesave në baza ditore, pas marrjes së raportit nga thesari;
 3. Në bashkëpunim me komunat, të bëhet identifikimi e pagesave të dështuara të regjistruara dhe të largohen nga lista e pagesave të dështuara;
-

-
4. Hartuar rregullore me anë të së cilës përkufizohet saktësisht shpërndarja e pagesës së realizuar;
 5. Të siguroj dokumentim të tërësishëm , për të gjitha proceset. Përfshirë këtu, dokumentimin e kartelës financiare, duke realizuar testimi i përgjithshëm i saj për të identifikuar mangësitë e mundshme në të dhe rezultatet e testimit të paraqiten tek menaxhmenti i larte i DTP-së. Të bëhet identifikimi i të gjitha kartelave me përmirësim bilanci, pastaj të identifikohen arsyet e këtij mosbarazimi, si dhe në bashkëpunim me komunat duke udhëzuar ato të bëhet vërtetimi i tyre në mënyrë që të eliminohet paqartësia lidhur me përshkrimin përmirësim bilanci. Gjithashtu, duhet të dokumentohet tërë procesi i funksionimit të modulit të faljes së borxheve. Si dhe të identifikojë të gjitha ndryshimet e bëra ne SITP dhe ti dokumentoj ato; dhe
 6. Të sigurohet që të ofroj raporte të ndryshme, sipas nevojave të shfrytëzuesve.
- Sigurohet të ofroj siguri shtesë duke hartuar procedurën për gjurmueshmëri të transaksioneve dhe aktiviteteve të shfrytëzuesve. Po ashtu të përcaktohet koha dhe vendi i ruajtjes së këtyre shënimeve, si dhe e drejta për qasje në këto shënime.
 - **Siguroj efektivitet në ofrimin e shërbimeve në përkrahje të shfrytëzuesve duke :**
 1. Hartuar dhe zbatuar procedurat për të ndërtuar funksionin e tavolinës ndihmese, duke shfrytëzuar kapacitete e veta, apo të përkrahura nga DTP-MF. Kjo tavolinë ndihmese, duhet te veprojnë si pikë e vetme dhe fillestare e kontaktit për paraqitjen, monitorimin, përshkallëzimin dhe zgjidhjen e kërkesave apo incidenteve të shfrytëzuesve.;
 2. Hartuar procedurat për ndryshim, të cilat përveç tjerash do të përfshinin : ndarjen e roleve dhe përgjegjësi për procesin e ndryshimeve, procesin për klasifikimin dhe prioritizimin e të gjitha ndryshimeve, procesin për vlerësimin e ndikimit, procesin për miratimin e ndryshimeve, procesin për përcjelljen e ndryshimeve dhe gjendjes së tyre, ndikimi i ndryshimeve në integritetin e të dhënave;
 3. Po ashtu duhet të hartoj procedurën për zbatimin e ndryshimeve emergjente, procedure kjo e cila përveç tjerash duhet të përfshijë në vete proceset e përgjithshme për të realizuar lajmërimin, vlerësimin, autorizimin dhe regjistrimin e një ndryshimi emergjent;
 4. Të krijohen dhe zbatohen rregullat për matjen e performancës së shërbimeve të nevojshme për mbarëvajtjen e SITP-se, duke përfshirë edhe performancën dhe kapacitetet e duhura për deponim, procedim dhe transmetim të informatave. Si dhe të identifikojë dhe përcaktojë masat e nevojshme korrigjuese me anë të cilave do të bëhet bartja apo zhvendosja e shërbimeve në rast të dështimit apo degradimit të performancës; dhe
 5. Në rast se DMSTI, nuk arrin të miratojë procedurat e nevojshme për realizimin e kopjeve rezervë, të hartoj ato për përdorim të brendshëm deri në miratimin e tyre.
-

Rekomandojmë DTP që në bashkëpunim me DMSTI që të:

- Rritet bashkëpunimi në mes të këtyre departamenteve sa i përket SITP-së; dhe
- DMSTI të përkrah DTP-në në hartimin e politikave dhe procedurave të nevojshme për SITP-në. Sidomos duke hartuar rregullat për matjen e performancës së shërbimeve të nevojshme për mbarëvajtjen e SITP-se, duke përfshirë edhe performancën dhe kapacitetet e duhura për deponim, procedim dhe transmetim të informatave, si dhe të hartoj procedura për kopje rezervë.

Rekomandojmë DTP që në bashkëpunim me Thesarin të:

- Të bëj identifikimin e arsyeve të mosbarazimeve në mes të sistemeve.

Rekomandojmë komunat:

- Zyrtarët e të hyrave në komuna duhet të bëjnë barazimet e të hyrave nga SIMFK dhe SITP, të identifikojnë arsyet e mosbarazimit, dhe të eliminohen gabimet e mundshme të lëshuara nga sistemi;
- Të identifikojë nevojat dhe ti adresojë dhe dokumentojë kërkesat për përmirësim të sistemit, drejtuar DTP-së;
- Të rritet bashkëpunimi në mes të komunave dhe DTP-se për përdorimin e praktikave të mira të sistemit; dhe
- TI-të e komunave, të bëjnë kontrollin e autorizimit të të drejtave të qasjes në kompjuter dhe të jepen privilegjet sipas detyrës.


Terminologjia

Ad hoc	vendime të ndërmarra aty për aty, apo vendime të momentit.
Aplikacionet	janë sistemet e automatizuara të përdoruesit dhe procedurat manuale që përpunojnë informacionin.
Baza e të dhënave	është një grumbullim i të dhënave kompjuterike të paraqitura në mënyrë të organizuar.
BUG	gabim ose lëshim i identifikuar, i cili pengon ne operimin e mirëfillte te sistemit
COBIT	(Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë Informativë), botim i Organizatës ndërkombëtare të Auditimit dhe Kontrollit të Sistemeve të Informacionit, ISACA (Information Systems Audit and Control Association), është një strukturë e përdorur gjerësisht, e cila përmbledh rekomandimet, praktikat dhe metodat më të mira të vlerësimit për kontrollet e përgjithshme IT, si dhe për programet që zhvillohen në këto ambiente.
Dokumentimi i sistemit	dokumentimi është një pjesë thelbësore e zhvillimit dhe përdorimit të një sistemi kompjuterik. Në dokumentimin e sistemit përfshihet duke regjistruar se si sistemi i ri do të punojë dhe si është zhvilluar. Po ashtu përfshihet testimi i sistemit, ruajtja e kopjeve rezervë.
Fjalëkalimi	është një fjalë ose varg karakteresh të përdorura për të autorizuar përdoruesit dhe vërtetuar miratimin e identitetit për qasje në sistem.
Gjeoportali	është një ueb portal që prezanton informacione gjeografike nga burime të ndryshme në një formë të unifikuar. Gjeoportalin është zhvilluar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për qëllim të ofrojë informacione të tërësishme gjeografike.
Gjurmueshmeria	Dëshmi që mund të listohen në mënyrë kronologjike hapat nga fillimi i një transaksion deri tek përfundimi i saj.
Infrastruktura	është teknologji dhe pajisje (hardware, sisteme operative, sistemi i menaxhimit të bazës së të dhënave, rrjetit, multimedia etj, dhe mjediset që i përkrahin ato) që mundësojnë përpunimin, transmetimin dhe deponimin e të dhënave dhe informatave.
Kontrollet e aplikacioneve	janë kontrolle specifike unike për çdo aplikacion të kompjuterizuar ku përfshihen procedura manuale të cilat operojnë ngushtësisht me aplikacionin.
Kopje rezerve (Backup)	procedura për krijimin dhe ruajtjen e kopjeve të të dhënave, të cilat do të shfrytëzoheshin në rast të humbjes apo dëmtimit të të dhënave origjinale.
Menaxhimi i help deskut (tavolinës ndihmëse)	reagimi i shpejtë dhe efektiv ndaj kërkesave të përdoruesve të IT dhe problemeve kërkon një help desk të mirë-dizajnuar dhe mirë-ekzekutuar, si dhe një proces të menaxhimit të incidenteve.
Menaxhimi i incidenteve	janë sistemet dhe praktikat e përdorura për të përcaktuar nëse incidentet ose gabimet janë regjistruar, analizuar dhe zgjidhur brenda një afati.

Menaxhimi i ndryshimeve	procesi i menaxhimit të ndryshimit normalisht përdoret për të menaxhuar dhe kontrolluar ndryshimet ndaj asetëve, si programet, pajisjet, dhe dokumentet e lidhura.
MC Access	është sistem i menaxhimit të bazës së të dhënave, nga Microsoft.
Ndryshimet emergjente	janë ndryshimet që nuk mund të presin të kalojnë përgjatë procedurave të kontrollit të ndryshimit dhe duhet të zbatohen me minimumin e vonesave. Dokumentimi i tyre mund të bëhet pas kalimit të fazës emergjente.
Ortofoto	imazh fotografik i marrë nga ajri.
Paisje harduerike	komponentët fizike të një sistemi kompjuterik.
Pagesat e dështuara	janë pagesa të cilat refuzohen nga aplikacioni, në rastet kur ndonjë nga elementet e pagesës nuk është valid apo është përsëritur.
Qasje administratori	ka mundësi të bëjë ndryshime në një pajisje/aplikacion që do të ndikojë tek përdoruesit e tjerë. Po ashtu të mund të ndryshojnë cilësinë e sigurisë, instalon softuerin dhe harduerin, të ketë qasje të gjitha skedarët në kompjuter dhe të bëjnë ndryshime në llogari të tjera të përdoruesit.
Qasja logjike	mundësia e ndërveprimit në aplikacion, në të dhëna apo infrastrukturë. Ky lloj i qasjes në përgjithësi përmban identifikimin, autentifikimin dhe protokollet e autorizimit
Qeverisje e TI	nënkupton udhëheqjen, strukturën organizative dhe proceset që sigurojnë që strategjia e IT-së ecë në përputhje me strategjinë dhe objektivat e organizatës
Siguria e aplikacionit	nënkupton ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së informacionit në elementet e aplikacionit.
Sistemi informativ (SI)	përfshinë në vete teknologjinë, njerëzit dhe proceset, për dallim nga teknologjia informative e cila përfshinë vetëm mjetet për të mundësuar atë si p.sh. hardueri dhe softueri.
Shenjë informuese	shenjë për të treguar informata të plota për lokacionin.
Shfrytëzuesit e privilegjuar	Këto u japin privilegje administrative në një ose më shumë sisteme. Ata janë forma më e zakonshme dhe zakonisht kanë fjalëkalime unike dhe komplekse që u japin atyre fuqi në të gjithë rrjetin. Këto janë llogaritë që duhet të monitorohen nga afër. Ndonjëherë, këto llogari nuk i përkasin përdoruesve individualë dhe janë të ndara në mes të administratorëve. Këto llogari duhet të monitorohen për atë se kush ka qasje, çfarë ata kanë qasje dhe sa shpesh kërkojnë qasje.
Testimi	<p>brenda saj janë katër fazat e testimit të sistemit:</p> <p>Testimi i njësive (që përdoret për të testuar logjikën e programit brenda një programi ose moduli të caktuar. Qëllimi i testit është që të sigurohet se operimi i brendshëm i programit kryhet sipas specifikimit.);</p> <p>Testimi i integritetit (testimi në grup i moduleve kur ato nderlidhen në mes veti);</p> <p>Testimi i sistemit (testimi i moduleve për të përcaktuar nëse janë pajtueshmëri me kërkesat e biznesit);</p>

	Testi i pranueshmërisë (testimi në lidhje me nevojat, kërkesat dhe proceset e biznesit të përdorura për të përcaktuar nëse një sistem i përmbush kriteret e pranimit dhe që t'i mundësojë përdoruesit, klientët ose entitetin tjetër të autorizuar të përcaktojë nëse do të pranojë ose jo sistemin).
Tavolinë ndihmëse	vendi, adresa apo pika e referimit ku përdoruesit mund të kërkojnë ndihmë për problemet në sistem.
Trajtimi i Gabimeve	gjatë transmetimit të të dhënave mund të ndodhin gabime. Ato duhet të zbulohen dhe të korrigjohen
UNIREF	Unified Reference Payment Code - Instrument i përdorur për identifikimin e klasifikimin e pagesave, si dhe regjistrimin e tyre në SIMFK.
Use case	është një listë e aktiviteteve ose hapat e ngjarjeve që përcaktojnë bashkëveprimin në mes të një roli/aktori dhe një sistem për të arritur një qëllim. Aktori mund të jetë njeriu apo ndonjë sistemi i jashtëm.
User	Shfrytëzues të autorizuar të sistemit

Shtojca 1: Të hyrat vetanake të komunave dhe pjesëmarrja në përqindje e tatimit në pronë për vitet 2014-2016



Burimi: Raportet vjetore të pasqyrave financiare të audituara nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2014-2016; të hyrat vetanake përfshijnë edhe të hyrat nga gjokat

Shtojca 2: Të hyrat nga tatimi në prone për vitin 2016 për komunat sipas përqindjes së pjesëmarrjes

Komuna	Të hyrat nga TP €	Pjesëmarrja në %
Prishtinë	7,176,272	28.56%
Prizren	2,201,130	8.76%
Ferizaj	2,074,797	8.26%
Gjilan	1,798,990	7.16%
Gjakove	1,563,827	6.22%
Peje	1,562,511	6.22%
Lipjan	838,950	3.34%
Mitrovice	777,165	3.09%
Suharekë	696,629	2.77%
Fushë Kosovë	615,679	2.45%
Podujevë	581,729	2.32%
Vushtrri	524,566	2.09%
Graçanicë	472,759	1.88%
Viti	377,042	1.50%
Rahovec	370,509	1.47%
Glllogovc	361,975	1.44%
Istog	297,767	1.44%
Obiliq	281,889	1.31%
Kline	281,392	1.19%
Malisheve	266,735	1.12%
Kaçanik	221,954	1.12%
Kamenice	202,123	1.06%
Deçan	192,358	0.88%
Skenderaj	161,611	0.80%
Dragash	124,709	0.77%
Shtime	113,185	0.64%
Shtërpçë	104,658	0.50%
Novo Bërd	60,376	0.45%
Hani i Elezit	48,563	0.42%
Klllokot	41,750	0.24%
Ranillug	22,561	0.19%
Junik	21,106	0.17%
Mamushë		0.09%
Partesh		0.08%
Leposaviq	-	0.00%
Zubin Potok	-	0.00%
Zveçan	-	0.00%
Mitrovicë Veriore	-	0.00%
Gjithsej	25,127,908	100.00%

Burimi: Të dhënat nga Thesari